



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
SENATI AKADEMIK

Nr. 2047 prot.
1

Elbasan, më 20 12/2021

VENDIM

Nr. 35 datë 17.12.2021

**"PËR
MIRATIMIN E HAPJES SË PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË TRETË
"DOKTORATË NË SHKENCAT E EDUKIMIT" NË FAKULTETIN E SHKENCAVE TË
EDUKIMIT"**

Bazuar në ligjin nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 3, pika 2/b; neni 35 pika 1/dh; neni 37 dhe neni 91, pika 3; në VKM nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga IAL" i ndryshuar; në Udhëzimin të MASR-së nr.1, datë 14.01.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit si dhe ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë" Kreu IV, germa "E"; në Statutin e UE, me propozim të Fakultetit të Shkencave të Edukimit, përcjellë me shkresën nr. 422/2, datë 03.12.2021, Senati Akademik,

V E N D O S I:

1. Miratimin paraprak të dokumentacionit për hapjen e programit të ciklit të tretë të studimeve "Doktoratë në shkencat e edukimit" në Fakultetin e Shkencave të Edukimit.
2. Ky vendim t'i dërgohet për procedura të mëtejshme Bordit të Administrimit të UE.
3. Ky Vendim, pas miratimit edhe nga Bordi i Administrimit, brenda datës së afatit të përcaktuar në platformën e-Albania të ngarkohet nga përgjegjësit e njësive bazë që kanë propozuar hapjen e programit të studimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.





REPUBLIKA E SHQIPËRISE

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
FAKULTETI I SHKENCAVE TË EDUKIMIT

PROJEKTI

“INTEGRIMI NDËRDISIPLINOR I KËRKIMIT NË SHKENCAT E EDUKIMIT”



Dhjetor, 2021



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
FAKULTETI I SHKENCAVE TË EDUKIMIT

TABELA E PËRMBAJTJES

1. Pasyra përmbledhëse e projektit	3
2. Konteksti	4
3. Përmbledhja e projektit	8
4. Përshkrimi i institucionit të arsimit të lartë ku do të implementohet projekti	10
5. Përshkrimi i bashkimit të njësive që do të implementojnë projektin	12
6. Përshkrim i detajuar i projektit	16
7. Metodologjia e projektit	22
8. Organizimi i studimeve doktorale	25
9. Produkte të projektit dhe aktivitete të lidhura me projektin	28
10. Analiza SWOT	29
11. Analiza e tregut të punës	32
12. Grupi i punës për implementimin e projektit	46
13. Të dhëna mbi kriteret e pranimin, tarifa dhe modalitete financiare	47





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
FAKULTETI I SHKENCAVE TË EDUKIMIT

PASQYRA PËRMBLEDHËSE E PRODUKTIT TË PROJEKTIT

- Fusha kryesore e kërkimit: Edukim
- Emërtimi i programit të studimeve të doktoraturës: Doktoraturë në Shkencë Edukimi
- Cikli i studimeve: Cikli i tretë
- Lloji i programit: Doktoraturë
- Njësitë bazë: Departamenti i Metodologjisë së Mësimdhënies
Departamenti i Shkencave Sociale dhe Edukimit Qytetar
Departamenti i Edukimit Fizik dhe Sportit
Departamenti i Psikologjisë
Qendra për Kërkim dhe Zhvillim në Edukim
- Njësia kryesore: Fakulteti i Shkencave të Edukimit
- Studimi me kohë normale shprehur në vite: 3 (tre)
- Studimi me kohë të zgjatur të shprehur në vite: 5 (pesë)
- Gjuha e studimit: shqip
- Të dhënat për koordinatorin e doktoraturës: Prof.as.dr. Elisabeta OSMANAJ
Pozicioni në IAL: Dekan i Fakultetit të Shkencave të Edukimit
E-mail: elisabeta.osmanaj@uniel.edu.al





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI” FAKULTETI I SHKENCAVE TË EDUKIMIT

I. KONTEKSTI

Vendi ynë ka ndërmarrë reforma të rëndësishme në fushën e arsimit në njëzet vitet e fundit, të cilat reflektojnë prioritetin e arsimit në politikat kombëtare të zhvillimit, në kuadër edhe të procesit të integritimit në Unionin Evropian (EU) dhe angazhimeve të tjera të lidhura me të prej vitit 2000¹, me qëllim vendosjen e edukimit në linjë me Qëllimin IV të Agjendës Ndërkombëtare për Zhvillim të Qëndrueshëm 2030 (SDG4), referuar të cilit, synohet të arrihet brenda vitit 2030, edukimi cilësor, gjithëpërfshirës dhe i barabartë për të gjithë duke promovuar njëkohësisht mundësi për të mësuarin përgjatë gjithë jetës².

Një qëllim i tillë i vendos IAL-të, në mënyrë të veçantë, fakultetet dhe departamentet që formojnë mësuesit e ardhshëm, përballë përgjegjësi dhe sfidave të dyfishta, jo vetëm në garantimin e standarteve më të larta në formimin profesional të mësuesve, por edhe në nxitjen e kërkitimit shkencor drejt hulumtimit të çështjeve akute dhe kritike në lidhje me edukimin. Edhe pse politikbërësit nga njëra anë, fokusohen tek reformat dhe zbatimi i tyre, ndërsa kërkesit në anën tjetër, tek vlerësimi i impaktit të reformave në cilësinë e mësimdhënies dhe të mësuesve, hende ku midis kërkitimit, praktikës edukative dhe hartimit të politikave nuk është ngushtuar (MAS, 2021). Studimet (p.sh., Healey & Jenkins, 2018³; Lingard, 2013⁴; Levin et al., 2013⁵) kanë treguar se (ri)ngritja dhe riorganizimi i

¹ UNESCO (2017). *Albania, Education Policy Review: Issues and Recommendations*, Paris: Section of Education Policy.

² United Nations (2015). *Transforming Our World: The 2030 Agenda for Sustainable Development*, gjetur më 11/12/2021 <https://sustainabledevelopment.un.org/content/documents/21252030920Agenda920for920Sustainable920Development920web.pdf>

³ Healey, M., Jenkins, A. (2018). The role of academic developers in embedding high-impact undergraduate research and inquiry in mainstream higher education: Twenty years' reflection, *International Journal for Academic Development*, Vol. 23, No. 1, f. 52-64.

⁴ Lingard, B. (2013). The impact of research on education policy in an era of evidence-based policy. *Critical Studies in Education*, Vol. 54, No. 2, f. 113-131.

⁵ Levin, B., Qi, J., Edelstein H., Sohn, J. (2013). *The impact of research in education*. Great Britain: Policy Press.





UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
FAKULTETI I SHKENCAVE TË EDUKIMIT

kapaciteteve të kërkimit përmes hapjes së programeve të studimeve doktorale në shkencat e edukimit, rezultat të jetë efektiv në zvogëlimin e hendekut midis praktikës dhe kërkimit në edukim, ku qasja e zakonshme fenomenologjike mundëson të kuptuarit e dimensioneve eksperimentale, relacionale dhe intersubjektive të pedagogjisë, të të mësuarit dhe të të nxënimit⁶. Së dyti, ndërton ura bashkëpunimi dhe dialogu midis agjensive të edukimit jashtë IAL-ve dhe kërkuesve brenda këtyj të fundit⁷.

Adoptimi i qasjes multidisiplinore në hulumtimet rreth edukimit nuk është një novacion paradigmatik. Gjurmimi historik i lindjes së shkencës së pedagogjisë në epokën moderne, evidenton karakterin *pluridisiplinar*⁸ të edukimit. Ky i fundit nevojitet të rridimensionohet dhe të institucionalizohet si një fushë disiplinore më vete – atë të shkencave të edukimit (d.m.th., një institucion social i specializuar në prodhimin, diskutimin dhe përhapjen e dijes rreth edukimit). Interesi rreth edukimit nuk është vetëm social, por i lidhur edhe me kërkesat në rritje për zhvillim personal dhe profesional⁹, evidentuar nga gjetja se 1/4 e studentëve të diplomuar në studimet master në Evropë dëshirojnë të ndjekin studimet doktorale¹⁰, por fatkeqësisht vetëm 1% e popullsisë evropiane e moshës 25-63 vjeç ia dalin t'i realizojnë ato¹¹. Komisioni Evropian (2007) udhëzoi vendet anëtare dhe të tjerat në proces e sipër të bëhen më kompetitivë në riorganizimin dhe ristrukturimin e programeve të ciklit të tretë të studimeve për t'iu përshtatur kërkesave dhe nevojave të tregut të punës. Kompleksiteti¹² i kompetencave që kërkohen prej mësuesit në shoqërinë bashkëkohore kërkon prej IAL-ve që të

⁶ Brinkmann, M., & Friesen, N. (2018). Phenomenology and education, Në *International handbook of philosophy of education* (f. 591-608). Springer, Cham.

⁷ Schratz, M., Cervinková, H., Halász, G., Pol, M., Timoca, L. (2019). *European doctorate in teacher education: Researching policy and practice*, Wrocław: EDITE.

⁸ Hofstetter, R., Schneuwly, B. (2002). Institutionalization of educational sciences and the dynamics of their development, *European Educational Research Journal*, Vol. 1, No. 1, f. 3-25.

⁹ Alves, M. G., Azevedo, N. R. (2010). Third-cycle studies in educational sciences: Expectations and competences development, *European Educational Research Journal*, Vol. 9, No. 1, f. 69-80.

¹⁰ Directorate-General Education and Culture, European Commission (2009). *Students and Higher Education Reform: survey among students in higher education institutions, in the EU member states, Croatia, Iceland, Norway and Turkey*, http://ec.europa.eu/public_opinion/flash/fl_260_sum_en.pdf

¹¹ European Commission (2007). *Key Data on Higher Education in Europe*. Luxembourg: Office for Official Publications of the European Communities.

¹² Cochran-Smith M. (2005). The politics of teacher education and the curse of complexity, *Journal of Teacher Education*, Vol. 56, No. 3, f. 181-185.





REPUBLIKA E SHQIPËRISE

UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI” FAKULTETI I SHKENCAVE TË EDUKIMIT

jenë në gjendje të ofrojnë programet më të mira të mundshme të edukimit të mësuesve në të tri ciklet e studimeve në arsimin e lartë¹³ ose trajnime të vazhdueshme nëpër faza të ndryshme të karrierës së tyre¹⁴.

Mungesa e analizave vendore për arsimin e lartë paraqet një faktor kufizues në procesin e planifikimit të ciklit III të studimeve në vendin tonë¹⁵, por përmes qasjes sekondare të gjetjeve parësore të studimeve, mund të parashikohet kriza e afërt e profesionit të mësuesit në rritjen e kërkesës për punë përballë numrit në ulje të nxënësve në SAPU¹⁶ dhe e profesionit të pedagogut nëse natyra e punës së të cilit do të përqendrohet vetëm në mësimdhënie. Ndërkohë që studimet eidentojnë se mësuesit jo vetëm që angazhohen në kërkim nga kërkuesit dhe akademikët në IAL-të (Cochran-Smith, 2005), por ata duhet të jenë në gjendje të iniciojnë kërkime në mjedisin kompleks të klasës – research based teaching¹⁷. Studentët e mësuesisë preferojnë të mësojnë në mjedise universitare ku ndodh kërkimi shkencor, pasi mjediset e bazuara tek kërkimi nën drejtimin e kërkuesve universitarë, kontribuojnë në zhvillimin e kompetencave praktike të mësuesve¹⁸ – praktika reflektive¹⁹.

Edhe pse programet e doktoraturës në fushën e pedagogjisë kanë një traditë në historinë e arsimit të lartë dhe të kërkimit shkencor shqiptar, paradigmat filozofike të shkencës kanë pësuar një evolucion dhe pluralizëm pas viteve '90, duke lejuar një këndvështrim multidisiplinar në proceset e të mësuarit, të cilat nuk kufizohen vetëm në mësimdhënien formale. Të mësuarit është një proces sa formal, aq edhe informal, duke e bërë atë psikologjikisht (konjitivisht) një proces që vazhdon deri në fund të jetës. Si i tillë, ai nuk

¹³ European Parliament Committee on Culture and Education (2008). *Report on improving the quality of teacher education*, https://www.europarl.europa.eu/doceo/document/A-6-2008-0304_EN.pdf.

¹⁴ ETUCE (2008). *Teacher education in Europe: An ETUCE policy paper*, Belgium” Imprimerie IPEX.

¹⁵ MASR (2021). *Strategjia Kombëtare e Arsimit 2021-2026*: Draft, Tiranë: Autori

¹⁶ Sistemi Arsimit Parauniversitar

¹⁷ Vula, E., Saqipi, B., Karaj, A. T., & Mita, N. (2012). Moving towards practice-oriented and Research-Based teacher education in Albania. *Excellence in Higher Education*, Vol. 3, No. 1, f. 37-45.

¹⁸ Cochran-Smith, M., & Lytle, S. L. (1999). Relationships of knowledge and practice: Teacher learning in communities. *Review of Research in Education*, Vol. 24, No. 1, f. 249-305.

¹⁹ Zeichner, K., & Liston, D. (1987). *Teaching and teacher education*. New York: Pergamon Press.





REPUBLIKA E SHQIPËRISE

UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI” FAKULTETI I SHKENCAVE TË EDUKIMIT

mund të ndahet dhe të kuptohet gjithmonë i izoluar nga biologjia, neurologjia, shoqëria, filozofia, historia, botëkuptimi individual, politika etj., dhe një studim rigoroz i tij nuk mundet veç të adoptojë një qasje holistike²⁰.

Përballë reformave të vazhdueshme në arsimin e lartë në Shqipëri përgjatë dekadave të fundit, sfidë e universitetit është integrimi i brendshëm i burimeve njerëzore dhe i kapaciteteve të tyre të mësimdhënies dhe kërkimit, në mënyrë që midis mësimdhënies si praktikë dhe kërkimit si akumulim të dijeve, të arrihet sinergjia e domosdoshme që krijon *dijen* si një të mirë publike, jo vetëm në shërbim të implementimit efikas të politikave zhvillimore të një vendi, por edhe të ndikimit në hartimin e politikave arsimore. Universiteti në dualizimin e tij - mësimdhënie dhe kërkim – nevojitet të gjejë sinergjinë e nevojshme midis nismave individuale kërkimore të pedagogëve dhe ta kthejë kërkimin në një aktivitet të institucionalizuar²¹, që do të thotë: a) agjendë kërkimore dhe b) kapacitete njerëzore për kërkimin. Kërkimi shkencor në IAL-të shqiptare është në nivel më të ulët krahasuar me IAL-të evropiane dhe ato të rajonit (MAS, 2021). Ngrija e programeve të studimeve të doktoraturës është ndër mënyrat efikase për të integruar dhe promovuar kërkimet individuale të pavaruara të stafit akademik në IAL-të në fusha specifike të dijeve, duke bërë të mundur njëherazi ndërtimin e identitetit si kërkues të IAL-së – research based university – dhe asimilimin e kapaciteteve të jashtme intelektuale në funksion të axhendës kërkimore të vetë IAL-së. Vetëm në organizimin si të tillë, dija si një formë kapitali brenda vetë IAL-së, i jep atij vlerën në tregun e sotëm të punës duke e bërë atë më kompetitiv. Kështu IAL-të zhvillohen jo vetëm së brendshmi, në mënyrë që të jenë tërheqës në ofertat e tyre ndaj studentëve potencialë, por edhe identifikohen si vatra intelektuale të ndikimit²² në komunitetin e tyre duke u kthyer në agjentë socialë të novacionit, ndryshimit dhe zhvillimit në shoqëri.

²⁰ Miller, R. (2000). Beyond reductionism: The emerging holistic paradigm in education. *The Humanistic Psychologist*, Vol. 29, No. 3, f. 1-3.

²¹ MAS (2021). *Strategjia Kombëtare e Arsimit 2021-2026*: Draft, f. 59, Tiranë: Autori

²² Bormann, L. (2012). What is the societal impact of research and how can it be assessed?: A literature survey. *Journal of the American Society for Information Science and Technology*, Vol. 64, No. 2, f. 217-233.





REPUBLIKA E SHQIPËRISE

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI" FAKULTETI I SHKENCAVE TË EDUKIMIT

2. PËRMBLEDHJA E PROJEKTIT

Projekti "Integrimi ndërdisiplinor i kërkimit në shkencat e edukimit" ka si mision formimin e profesionistëve të kualifikuar në shkencat e edukimit nëpërmjet realizimit të kërkimit shkencor efektiv dhe zhvillimor. Projekti udhëhiqet nga rëndësia mëse e evidentuar tashmë se arsimit dhe edukimi cilësor qëndron jo vetëm në themel të zhvillimit personal dhe profesional, por edhe të atij social, ekonomik dhe demokratik të një shoqërie. Implementimi i projektit orientohet drejt krijimit të Programit të Doktoratës "Në shkencat e edukimit". Përmes zhvillimit të projekteve kërkimore individuale, synohet të kuptohen dhe t'u jepen zgjidhje sfidave aktuale dhe atyre në të ardhmen që lidhen me sistemin arsimor, politikat e zhvillimit të arsimit, zhvillimin e kurrikulave në edukimin formal dhe joformal, vlerësimin e metodologjive të mësimdhënies, zbatimin e praktikave më të mira në mësimdhënie dhe kërkim etj. Realizimi i projekteve kërkimore individuale përfshin një periudhë pesëvjeçare, nga momenti i miratimit të tij në organet kolegjiale të institucionit të arsimit të lartë.

2.1 Qëllimet dhe objektivat e projektit mund të përmbliken si më poshtë vijon:

Qëllimi i parë kryesor i projektit përfshin të mësuarin dhe të kuptuarin në nivel të avancuar të teorive dhe aftësive metodologjike për praktikën akademike duke punuar në pikëtakimet e disiplinave të ndryshme.

Qëllimi i dytë kryesor i projektit është konsolidimi i temave të përbashkëta dhe i interesave të kërkimit për të nxitur përmirësimin e bashkëpunimit midis kërkuesve me backgrounde të ndryshme akademike dhe të niveleve të ndryshme të ekspertizës nga një numër disiplinash.

Qëllimi i tretë i projektit është t'u ofrojë mundësi të zhvillimit të karrierës studentëve të FSHE-së që përfundojnë programet e masterave shkencorë në fushën e mësuesisë, psikologjisë së edukimit, punës sociale dhe edukimit fizik në referencë me Komizën Shqiptare të Kualifikimeve, Ligji nr. 10 247, niveli 5 – 8, që përfshin kualifikimet nga niveli bachelor deri në doktoratë. Projekti u ofron mundësi profesionistëve në distancë lehtësisht të aksesueshme me UE për ndjekjen e studimeve të doktoratës pa





REPUBLIKA E SHqipërisë

UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI” FAKULTETI I SHKENCAVE TË EDUKIMIT

shkëputje në puna, përfishi këtu edhe stafin akademik me kohë të pjesëshme të angazhuar pranë FSHH-së dhe UE-së, të cilët aktualisht përbëjnë një përqindje të konsiderueshme të kontributit në procesin e mësimdhënies

2.2 Objektivat e projektit :

- Përgatitja e studiuësve dhe kërkuesve në fushën e edukimit që do të mundësojnë ekspertizë akademike në arsimin e lartë, përgjatë hartimit të politikave arsimore në Shqipëri, kontribut në përmirësimin e kurrikulës në arsimin parauniversitar, në institucionet kërkimore të vendit dhe në drejtoritë dhe zyrat arsimore vendore;
- Familjarizimi me fushën kërkimore dhe rëndësinë e saj sociale;
- Zotërimi i aftësive për të zbatuar në mënyrë kritike dhe të pavarur metodat e kërkimit shkencor duke kontribuar në dijen shkencore;
- Njohjen me zhvillimin historik dhe çështjet themelore të metodave kërkimore në shkencat e edukimit;
- Zotërim të njohësishëm të teorisë shkencore në disiplinën e lidhura me fushën e tyre kërkimore në mënyrë që të jenë në gjendje të ndjekin zhvillimet e ardhshme në secilën prej disiplinave;
- Në terma afatshkurtër, projekti mundëson bashkimin dhe integrimin e burimeve njerëzore, ekspertizës, hapësirave fizike etj., ndërsa në terma afatmesme dhe afatgjata: a) lehtëson aplikimin për financimin e projekteve të ndryshme kërkimore bazuar në njohjen e zgjeruar të kapaciteteve të veçanta kërkimore dhe zgjerimin e tematikave të hulumtimit nga krijimi i grupeve interdisiplinore të kërkimit dhe b) nxit të menduarin kreativ rreth zhvillimit të programeve interdisiplinore të kërkimit, në një kohë ku numri i studentëve të regjistruar në disiplina të veçanta shënon rënie çdo vit akademik;
- Bashkëpunimi me partnerë kombëtarë e ndërkombëtarë në kuadër të projektit dhe forcimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit me partnerë të huaj dhe vendas;
- Ngritja e grupeve kërkimore ndërdepartamentale që specifikojnë dhe orientojnë fushat kryesore të kërkimit funksionalitë cilave parashikohet të rregullohet nga Komisioni i Përhershëm pranë njësisë qendrore (sipas Nenit 46, të ligjit 80/2015 dhe Rregullorja e studimeve për programin e doktoratës në shkencat e edukimit;





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI” FAKULTETI I SHKENCAVE TË EDUKIMIT

- Zhvillim të kapaciteteve në hartimin dhe aplikimin e projekteve kërkimore. Institucionet e arsimit të lartë, që ofrojnë studime të doktoratës, hartojnë projekte kërkimore-shkencore dhe zhvillimi për këto studime dhe mund të aplikojnë për financim pranë AKKSHI-t apo institucioneve të tjera financuese (Neni 79, Ligji 80/2015);
- Ndërtimi i databazës së të dhënave në FSHE në lidhje me çështje të ndryshme rreth edukimit, që mund të shërbejnë si burim të dhënash për analiza të thelluara ose meta-analiza;
- Zhvillim dhe zbatim të projekteve individuale kërkimore sipas Kodit Europian të sjelljes për integritet në kërkimin shkencor²³ dhe Ligjin për kodin e sjelljes për integritet në kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë²⁴.

3. PËRSHKRIMI I INSTITUCIONIT TË ARSIMIT TË LARTË KU DO TË IMPLEMENTOHET PROJEKTI

Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”, i themeluar në vitin 1991, është institucion i rëndësishëm arsimor e shkencor në Republikën e Shqipërisë, një nga universitetet më në zë të vendit për përgatitjen e mësuesve, të specialistëve dhe studiuesve të rinj në fusha të ndryshme të studimeve. Historia e tij për afro 4 dekada ka njohur arritje të dukshme në shumë fusha të veprimitarisë së procesit mësimor dhe kërkimor. Universiteti është ngritur mbi një traditë të pasur në këtë drejtim. Pa dyshim kjo traditë ka të bëjë dhe është e lidhur ngushtë me Shkollën Normale, të çelur më 1909, e cila luajti për shumë kohë rolin e një universiteti të vërtetë

Sot, Universiteti i Elbasanit, vazhdon traditën arsimore në fushën e mësuesisë por edhe në fusha të reja e dinamike të dijës e kërkimit shkencor. Veprimtaria e Universitetit bazohet në nenin 57, pika 7, të Kushtetutës, në Ligjin nr.80/2015 datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë Republikën e Shqipërisë", në Statutin e Universitetit dhe në rregulloret që miratohen në zbatim të tij.

²³ All European Academies (2018). Kodi Europian i sjelljes për integritet në kërkimin shkencor, Botim i rishikuar, Berlin: Akademia e Shkencave dhe e Studimeve Humane, https://www.allea.org/wp-content/uploads/2018/06/ALLEA-Albanian-European-Code-of-Conduct-for-Research-Integrity_FINAE.pdf

²⁴ http://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2018/07/KODI_ETIK.pdf





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
FAKULTETI I SHKENCAVE TË EDUKIMIT

Në mënyrë të detajuar në UE funksionojnë:

- I. Fakulteti i Shkencave Humane**, me programe studimi Bachelor, Master profesional, Master i shkencave dhe Doktoratë në fushat e kërkimit të tij: gjuhë shqipe dhe të huaj (anglisht, frëngjisht, italisht, gjermanisht), histori, gjeografi, gazetari, albanologji, programe profesionale 2-vjeçare në sekretar i specializuar dhe operator turistik në gjuhën gjermane.
- II. Fakulteti i Shkencave të Natyrës**, me programe studimi Bachelor, Master profesional dhe Master i shkencave në fushat e kërkimit të tij: biologji, kimi, botanikë, zoologji, mbrojtje mjedisi, matematikë, fizikë, teknologji e informacionit, informatikë, gjeometri, fizikë teorike e eksperimentale si dhe programe profesionale 2-vjeçare në teknik laborator, teknik mjedisi, mekatronikë, logjistikë.
- III. Fakulteti i Shkencave të Edukimit**, me programe studimi Bachelor, Master profesional dhe Master i shkencave në fushat e kërkimit të tij: mësuesi për arsimin fillor (klasa I-V të shkollës 9-vjeçare), mësuesi për arsimin parashkollor, psikologji, filozofi-sociologji, edukim fizik dhe sporte si dhe program profesional 2-vjeçar në edukator për fëmijët 0-3 vjeç.
- IV. Fakulteti Ekonomik**, me programe studimi Bachelor, Master profesional dhe Master i shkencave në fushat e kërkimit të tij: administrim, biznes, financë, kontabilitet, ekonomia dhe e drejta, shkenca juridike në biznes, shkenca juridike në sektorin publik, ekonomi-turizëm, administrim biznes dhe inxhinieri dhe informatikë ekonomike.
- V. Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike**, programe studimi Bachelor, Master profesional dhe Master i shkencave në fushat e kërkimit të tij: infermieri, infermieri-mami, teknik laborator, imazheri, manaxhim infermieror, dizajneri dhe logopedi





REPUBLIKA E SHQIPËRISE

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI" FAKULTETI I SHKENCAVE TË EDUKIMIT

Që nga themelimi i UE-së (1991) e në vijimësi punohet për krijimin e strukturave dhe institucioneve ndihmëse për procesin mësimor dhe veprimtarinë kërkimore-shkencore. Si kërkesa të natyrshme të ristrukturimit të UE-së dhe si ndihmëse në procesin e mësimdhënies, janë ngritur e janë vënë në dispozicion laboratorë teknikë pranë secilës njësi kryesore.

Bashkërendimi i orëve teorike në të gjitha programet e studimit me orët e praktikës në laboratorë apo pranë institucioneve bashkëpunëtoresh të UE-së, ka krijuar një rridimensionim të hapësirës së studentit. Politikat institucionale me në qendër studentin, kanë krijuar hapësira të pafundme për ndërkombëtarizimin e UE-së, duke u ofruar studentëve mundësi të barabarta të pjesëmarrjes në programet e mobilitetit jashtë vendit. Gjithashtu kjo politikë është integruar me partneritetet brenda dhe jashtë vendit, për të realizuar trajnime e kualifikime të ndryshme.

Politika e ndërkombëtarizimit ka patur një shtrirje të gjerë mes personelit të UE-së. Kjo ka mundësuar shkëmbime të personelit me universitetet partnere si dhe ka nxitur e kontribuar në rritjen e kapaciteteve, në kuadër të projekteve për ngritjen e kapaciteteve të Bashkimit Evropian. Kjo ka sjellë si pasojë një sërë aktiviteteve ndërkombëtare në UE.

Koncepti për të ardhmen e Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" mbështetet jo thjesht në afërsinë e tij pranë tregut të punës, transaksioneve dhe sferës utilitare, por, pse jo, edhe i shkapëputur prej tyre, pasi misioni i universiteteve nuk duhet të jetë vetëm që të prodhojë punëtorët dhe specialistët e fushave të ndryshme të kulturës dhe prodhimit, por edhe të formojë mbrojtësin dhe siguruesin e lirisë e të drejtave shoqërore dhe qytetare në Shqipëri.

3.1 PËRSHKRIMI I BASHKIMIT TË NJËSIVE QË DO TË IMPLEMENTOJNË PROJEKTIN

Për realizimin e projektit është nënshkruar marrëveshja e bashkëpunimit me qëllim realizimin e programit të ciklit të tretë Doktoraturë në Shkencat e Edukimit. Njësitë bazë, të cilat do të implementojnë projektin janë:





REPUBLIKA E SHQIPËRISE

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI" FAKULTETI I SHKENCAVE TË EDUKIMIT

Njësia bazë

Njësia kryesore

Departamenti i Metodologjisë së Mësimdhënies	Fakulteti i Shkencave të Edukimit
Departamenti i Shkencave Sociale dhe Edukimit Qytetar	Fakulteti i Shkencave të Edukimit
Departamenti i Edukimit Fizik dhe Sportit	Fakulteti i Shkencave të Edukimit
Departamenti i Psikologjisë	Fakulteti i Shkencave të Edukimit
Qendra për Kërkim dhe Zhvillim në Edukim	Fakulteti i Shkencave të Edukimit

Fakulteti i Shkencave të Edukimit është pjesë e Universitetit "A. Xhuvani", e cila është vazhdim i Shkollës Normale të vitit 1909. Hapja e Shkollës Normale në qytetin e Elbasanit është "djepi i të mësuarit dhe njohurive kombëtare" sipas përcaktimit të drejtorit të parë, Z. Luigj Gurakuqi. Krijimi i FSHE-së ka të bëjë me historikun e krijimit të ILP "A. Xhuvani" në vitin 1971, me synimin kryesor përgatitjen e mësuesve të profileve të ndryshëm. Në vitin 1981 u hap dega e përgatitjes së mësuesve për shkollën filllore. Në 1991 u krijua si një Fakultet i veçantë me dy Departamente.

Pas reformave të cilësisë në Universitetin "A. Xhuvani" më 05.12.2007, Fakulteti i Shkencave të Edukimit u krijua duke bashkuar ish-Fakultetin e Mësimdhënies dhe ish-Fakultetin e Shkencave Sociale të këtij Universiteti. Motoja e Universitetit A. Xhuvani dhe FSHE është "Nga tradita te suksesit". Ndryshimet në formë dhe strukturë u pasuan menjëherë nga ndryshimet në përbajtje. FSHE forcoi dhe thelloi programet ekzistuese të studimit në fushën e arsimit, për të cilat konsiderohet tradicionalisht si një Fakultet "Drejtues" në të gjithë vendin, si dhe zgjeroi dhe përmirësoi më tej cilësinë e programeve të studimit në drejtim të Mësimdhënies, filozofisë, puna sociale, psikologjia, edukimi qytetar dhe edukimi fizik dhe sportet.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”
FAKULTETI I SHKENCAVE TË EDUKIMIT**

Fakulteti i Shkencave të Edukimit ofron dy cikle studimi: Bachelor dhe Master (profesional shkencor) si dhe një program profesional 2-vjeçar në “Eduktor për fëmijët 0-3 vjeç”.

Programet e ciklit të parë të studimeve

1. Bachelor në Mësuesi për Arsimin Parashkollor,
2. Bachelor në Mësuesi për Arsimin Fillor,
3. Bachelor në Punonjës Social
4. Bachelor në Psikologji
5. Bachelor në Filozofi – Sociologji
6. Bachelor në Edukim Fizik dhe Sporte

Programet e ciklit të dytë të studimeve

1. Master i Shkencës në Mësuesi për Arsimin Fillor,
2. Master Profesional në Mësuesi në AMU për Matematikë-Fizikë me profil minor në Informatikë,
3. Master Profesional në Mësuesi në AMU për Matematikë-Informatikë me profil minor në Fizikë,
4. Master Profesional në Mësuesi në AMU për Biologji-Kimi me profil minor në Edukim Shëndetësor dhe Mjedisor,
5. Master Profesional në Mësuesi në AMU për Gjuhë e huaj Angleze me profil minor Gjuhë Shqipe”,
6. Master Profesional në Mësuesi në AMU për “Gjuhë e huaj frënge me profil minor Gjuhë Shqipe,
7. Master Profesional në Mësuesi në AMU për Gjuhë e huaj Italiane me profil minor Gjuhë Shqipe,
8. Master Profesional në Mësuesi në AMU për Gjuhë e huaj gjermane me profil minor në Gjuhë Shqipe,
9. Master Profesional në Mësuesi në AMU për Edukatë Qytetare-Histori me profil minor në Gjeografi,
10. Master Profesional në Mësuesi në AMU për Edukatë Qytetare-Gjeografi me profil minor në Histori,
11. Master Profesional në Mësuesi në AMU për Histori-Gjeografi me profil minor në Edukatë Qytetare,
12. Master Profesional në Mësuesi në AMU për Gjuhë Shqipe dhe Letërsi,
13. Master Profesional në Edukim Fizik dhe Sporte me profil minor në edukim shëndetësor
14. Master Profesional në Drejtim dhe administrim arsimit,





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
FAKULTETI I SHKENCAVE TË EDUKIMIT

15. Master Profesional në Mësuesi për Arsimin special
16. Master Profesional në Psikolog në Institucione
17. Master Profesional në Punonjës social me fëmijët dhe familjen,
18. Master Profesional në Shërbim Prove,
19. Master i Shkencave në Shërbime Sociale
20. Master i Shkencave në Psikologji Edukimi

Program profesional 2-vjeçar

1. "Edukator për fëmijët 0-3 vjeç"

Objekti i studimit në FSHE, qëllimet dhe objektivat e të mësuarit për realizimin e njohurive, vlerave dhe aftësive, sigurojnë realizimin e standardeve për funksionimin e këtij Fakulteti.

Përmes studimeve në FSHE synon të përgatisë studentët me të gjitha risitë bashkëkohore për të mësuarin, të drejtat dhe liritë themelore, shqetësimin për llogaridhënien publike dhe sociale, ndjeshmërinë ndaj problemeve globale me fokus në zhvillimin dhe zgjidhjen e sfidave, vlerësimin e çështjeve të natyrës dhe mjedisit dhe një lidhje të qëndrueshme me maturanët.

Misioni i Fakultetit të Shkencave të Edukimit:

- sigurimi i cilësisë përmes programeve përkatëse;
- pjesëmarrja në kërkimin shkencor;
- pjesëmarrja në aktivitete profesionale.

Studentët kanë mundësinë të përdorin komunikimin dhe aftësitë themelore për qëllime dhe situata që do të hasin në jetë, të zhvillojnë aftësinë për të realizuar koncepte dhe parime kryesore nga shkencat shoqërore dhe humane, aftësinë për të arriturë individë me





REPUBLIKA E SHQIPËRISE

UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI” FAKULTETI I SHKENCAVE TË EDUKIMIT

vetëbesim, aftësinë për t'u bërë anëtarë përgjegjës të familjes, grupit të punës dhe komunitetit, për të zhvilluar aftësitë e tyre për të menduar dhe zgjidhur problemet dhe sfidat në shkollë dhe në jetë, për të zhvilluar aftësi për të lidhur dhe integruar përvojën e re dhe njohuritë e reja duke mbajtur parasysh të mësuarit gjatë gjithë jetës.

FSHE ofron mjedise cilësore të mësimdhënies dhe të të nxënit, si dhe një bazë efektive teknologjike në departamentet përkatëse. Fakulteti i Shkencave të Edukimit është i përkushtuar të inkurajojë shkëmbimin e ideve dhe perspektivave të ndryshme duke bashkëpunuar me fakultete brenda dhe jashtë vendit. Studentët që kanë përfunduar studimet për vite e dekada punojnë në profesionin e mësuesit në vendin tonë, në zonën shqipfolëse, por edhe në shumë vende të tjera, për përhapjen e gjuhës shqipe, për të ruajtur dhe trashëguar identitetin tonë si pjesë e kulturës globale.

4. PËRSHKRIMI I DETAJUAR I PROJEKTIT

4.1 Hyrje

Interdisiplinariteti, i cili kuptohet si fenomeni i përgjithshëm i kombinimit dhe i integritit të perspektivave disiplinore, është një nga qasjet më madhore të akademisë së shek. XXI, pasi kompleksiteti i sfidave të shoqërive të sotme, ekonomive kompetitive dhe demokracive pluraliste i kapërcen kufijtë e disiplinave tradicionale (monodisiplinave). Kërkimi në arsimin e lartë lipset që të ridimensionohet si një fushë interdisiplinare, ku operojnë komunitete akademike dhe kërkimore të disiplinare të ndryshme²⁵. Ekzaminimi i literaturës shkencore në shumicën e disiplinave në arsimin e lartë evidenton trendin drejt studimeve interdisiplinare përkundrejt gjendjes aktuale të kërkimit bazuar në monodisiplinë, p.sh., numri i artikujve me shumë autorë ose bashkëpunëtorë të disiplinave të ndryshme shënon rritje kohët e fundit në secilën prej disiplinave sipas statistikave të Thomson Reuters Web



²⁵ Hiodn, S. (2018). Conducting interdisciplinary research in higher education: Epistemological styles, evaluative cultures and institutional obstacles. *International Journal of Interdisciplinary Research and Innovations*, Vol. 6, No.3, f. 288-297.

UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI” FAKULTETI I SHKENCAVE TË EDUKIMIT

of Science²⁶. Të afuarit bashkë e kërkuesve dhe studiuesve në një projekt kërkim i afëson ekipet e kërkimit në kryerjen e kërkimeve të nivelit të lartë që është jo vetëm gjithëpërfshirës, por edhe kompetent për të ofruar pikëpamje të ndryshme²⁷. Interdisiplinariteti në arsimin e lartë i referohet integritit të dy ose më shumë disiplinave ose fushave të studimit në lidhje (ose në raport) me kërkimin, mësimdhënien ose programet e studimit dhe ofrimin e diplomave ose certifikatave. Interdisiplinariteti mund të ekzistojë ose brenda vetë një IAL-je ose brenda dy ose më shumë IAL-ve²⁸.

4.2 Përkufizime

Kërkimi interdisiplinor është ai lloj i kërkimit realizuar nga individë apo ekipe që integron informacione, të dhëna, teknika, mjete, perspektiva, koncepte dhe teori nga dy ose më shumë disiplina apo fusha të specializuara të dijes me synim avancimin e të kuptuarit ose të zgjidhurit të problemeve²⁹. Konceptualizimi i shkencës së edukimit si një ndërmarrje interdisiplinare mbështetet në kontekstet e veta divergjente institucionale dhe qasjet e veta kërkimore multimetodike³⁰. Edukimi dhe proceset e lidhura me të, janë studiuar vazhdimisht nën këndvështrimin e shumë disiplinave si p.sh., psikologjia, sociologjia, filozofia, historia, ekonomia, jurisprudencia etj, duke bërë që kërkimi në fushën e shkencave të edukimit të adoptojë një komizë multidisiplinore ose ndërdisiplinore në mënyrë që të arrihet thellësia dhe cilësia e hulumtimit shkencor. Integrimi i sotëm në procesin edukacional Evropian i shoqërisë shqiptare dhe natyra e re e programeve të edukimit në sistemin arsimor në kuadrin e procesit të thellimit të dijes shkencore dhe avancimit teknologjik, kërkon integrimin e shkencave në fusha të ndryshme të edukimit. Baza filozofike e marrëdhënieve interdisiplinore është

²⁶ Voosen, P. (2013). Microbiology leaves the solo author behind. *Chronicle of Higher Education*; **60** (11): A16.

²⁷ van Eeden, E. S. (2011). Environmental history within a revitalized integrative research methodology for today and tomorrow. *Interdisciplinary Science Reviews*; **36** (4): 314–329

²⁸ Jacob. J. W. (2015). Interdisciplinary trends in higher education, Palgrave Communications, <https://www.nature.com/articles/palcomm2015011>

²⁹ Committee on Facilitating Interdisciplinary Research, Committee on Science, Engineering, and Public Policy (2004). *Facilitating Interdisciplinary Research*. National Academies, Washington: National Academy Press, f. 2.

³⁰ Terhart, E. (2017). Interdisciplinary research on education and its disciplines: Processes of change and lines of conflict in unstable academic export cultures: Germany as an example, *European Educational Research Journal*, Vol. 16, No. 6, f. 921-936.

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI" FAKULTETI I SHKENCAVE TË EDUKIMIT

qasja epistemologjike e *përshfaqësisë* versus reduksionizmit, e cila adopton pluralizmin shkencor, sipas këtij të fundit për një sërë fenomenesh komplekse të natyrës sociale dhe psikologjike ekzistojnë modele shkencore të shumëllojshme që operojnë njëkohësisht.

Sipas ISCED (2011)³¹ shkencat e edukimit merren me studimin e proceseve të të mësuarit dhe teorive, metodave dhe teknikave të transmetimit ose përcjelljes të dijes tek të tjerët. Ato përfshijnë zhvillimin e kurrikulave në fushat vokacionale dhe jo-vokacionale, studimet e kurrikulës, didaktikën, vlerësimin edukacional, testimin dhe matjen edukacionale, kërkimin edukacional dhe shkencat pedagogjike. Çështje të tjera me lidhura me edukimin përfshijnë lidhësinë në kontekstin e zhvillimit personal, edukimin dhe trajnimin në vendet e punës, edukimin joformal, programet për njerëzit me aftësi të veçanta në aftësimin e përballimit të detyrave të jetës së përditshme etj.

4.3 Qëllimi dhe objektivat e projektit

Projekti "Integrimi ndërdisiplinor i kërkimit në shkencat e edukimit" ka si mision formimin e profesionistëve të kualifikuar në shkencat e edukimit nepërmjet realizimit të kërkimit shkencor efektiv dhe zhvillimor. Projekti udhëhiqet nga rëndësia mëse e evidentuar tashmë se arsimit dhe edukimi cilësor qëndron jo vetëm në themel të zhvillimit personal dhe profesional, por edhe të atij social, ekonomik dhe demokratik të një shoqërie. Implementimi i projektit orientohet drejt krijimit të Programit të Doktoratës "Në shkencat e edukimit". Përmes zhvillimit të projekteve kërkimore individuale, synohet të kuptohen dhe t'u jepen zgjidhje sfidave aktuale dhe atyre në të ardhmen që lidhen me sistemin arsimor, politikat e zhvillimit të arsimit, zhvillimin e kurrikulave në edukimin formal dhe joformal, vlerësimin e metodologjive të mësimdhënies, zbatimin e praktikave më të mira në mësimdhënie dhe kërkim etj. Realizimi i projekteve kërkimore individuale përfshin një periudhë pesëvjeçare, nga momenti i miratimit të tij në organet kolegjiale të institucionit të arsimit të lartë.



³¹ http://uis.unesco.org/sites/default/files/documents/international-standard-classification-of-education-isced-2011_en.pdf



REPUBLIKA E SHQIPËRISE

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI" FAKULTETI I SHKENCAVE TË EDUKIMIT

Qëllimet dhe objektivat e projektit mund të përmbliken si më poshtë vijon:

Qëllimi i parë kryesor (Q1) i projektit përfshin të mësuarin dhe të kuptuarin në nivel të avancuar të teorisë dhe aftësive metodologjike për praktikën akademike duke punuar në pikëtakimet e disiplinave të ndryshme. Aftësitë e fituara në këtë program janë të përshtatshme jo vetëm në fushën e kërkimit, por edhe për role të tjera praktike në një sërë fushash profesionale. Programi dezinjohet për ata individë që synojnë një karrierë në kërkimin edukacional me qëllim për të takuar nevojën kombëtare për edukatorë dhe mësues të tërë për të përgatitur në çështjet metodologjike të kërkimit në edukim. Në përfundim të studimeve të doktoratës, kërkuesit e rinj do të kenë zotëruar dije teorike dhe aftësi metodologjike të kërkimit për të kontribuar si lektorë në IAL, kërkues shkencorë në qendrat të kërkimit në universitete, bashkëpunëtorë në kërkim në grupe të punës në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare, zhvillues ose studiues në agjensi të ndryshme të lidhura me arsimin dhe edukimin ose profesionistë në sistemin arsimor dhe shërbime edukacionale me standarte të larta profesionale dhe të mirëpaguar.

Objektiva të lidhura me Q1

- Përgatitja e studiuesve dhe kërkuesve në fushën e edukimit që do të mundësojnë ekspertizë akademike në arsimin e lartë, përgjatë hartimit të politikave arsimore në Shqipëri, kontribut në përmirësimin e kurrikulës në arsimin parauniversitar, në institucionet kërkimore të vendit dhe në drejtoritë dhe zyrat arsimore vendore
- Famjarizimi me fushën kërkimore dhe rëndësinë e saj sociale
- Zotërimi i aftësive për të zbatuar në mënyrë kritike dhe të pavarur metodat e kërkimit shkencor duke kontribuar në dijen shkencore
- Njohjen me zhvillimin historik dhe çështjet themelore të metodave kërkimore në shkencat e edukimit
- Zotërim të mjaftueshëm të teorisë shkencore në disiplinat e lidhura me fushën e tyre kërkimore në mënyrë që të jenë në gjendje të ndjekin zhvillimet e ardhshme në secilën prej disiplinave





REPUBLIKA E SHQIPËRISE

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI" FAKULTETI I SHKENCAVE TË EDUKIMIT

Qëllimi i dytë kryesor i projektit (Q2) është konsolidimi i temave të përbashkëta dhe i interesave të kërkimit për të nxitur përmirësimin e bashkëpunimit midis kërkuesve me backgrounde të ndryshme akademike dhe të niveleve të ndryshme të ndryshme të ekspertizës nga një numër disiplinash. Synohet të punohet rreth atyre projekteve kërkimore që adresojnë tema të rëndësishme dhe bashkëkohore në fushën e edukimit duke kombinuar studimet teorike, empirike, multidisiplinare, historike dhe ato krahasuese, duke përfshirë interpretime të informuara ose bazuar në evidenca – evidence based – të rezultateve të kërkimit, të cilat mund të ilustrojnë rëndësinë e tematikave të përzgjedhura për politikbërësit, kërkuesit, agjencitë të ndryshme të financimit, menaxherët e IAL-ve, si dhe organizatat e tjera publike të kërkimit.

Objektiva të lidhura me Q2

- Në terma afatshkurtër, projekti mundëson bashkimin dhe integrimin e burimeve njerëzore, ekspertizës, hapësirave fizike etj., ndërsa në terma afatmesme dhe afatgjata a) lehtëson aplikimin për financimin e projekteve të ndryshme kërkimore bazuar në njohjen e zgjeruar të kapaciteteve të veçanta kërkimore dhe zgjerimin e tematikave të hulumtimit nga krijimi i grupeve interdisiplinore të kërkimit dhe b) nxit të menduarin kreativ rreth zhvillimit të programeve interdisiplinore të studimit, në një kohë ku numri i studentëve të regjistruar në disiplina të veçanta shënon rënie çdo vit akademik.
- Bashkëpunimi me partnerë kombëtarë e ndërkombëtarë në kuadër të projektit dhe forcimi i marrëveshjeve ekzistuese të bashkëpunimit me partnerë të huaj dhe vendas
- Ngrija e grupeve kërkimore ndërdepartamentale që specifikojnë dhe orientojnë fushat kryesore të kërkimit, funksionimi i të cilave parashikohet të rregullohet nga Komisioni i Përhershëm pranë njësisë qendrore (sipas Nenit 46, Ligji 80/2015) dhe Rregullorja e studimeve për programin e doktoratës në shkencat e edukimit
- Zhvillim të kapaciteteve në hartimin dhe aplikimin e projekteve kërkimore. Institucionet e arsimit të lartë, që ofrojnë studime të doktoratës, hartojnë projekte kërkimore-shkencore dhe zhgjidhni për këto studime dhe mund të aplikojnë për financim pranë AKKSHI-t apo institucioneve të tjera financuese të Ligji 80/2015)

REPUBLICAN UNIVERSITY OF ELBASAN



**UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”
FAKULTETI I SHKENCAVE TË EDUKIMIT**

- Ndërtimi i databazës së të dhënave në FSHE në lidhje me çështje të ndryshme rreth edukimit, që mund të shërbejnë si burim të dhënash për analiza të thelluara ose meta-analiza
- Zhvillim dhe zbatim të projekteve individuale kërkimore sipas Kodit Europian të sjelljes për integritet në kërkimin shkencor³² dhe Ligjin për kodin e sjelljes për integritet në kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë³³

Qëllimi i tretë i projektit (Q3) është t'u ofrojë mundësi të zhvillimit të karrierës studentëve të FSHE-së që përfundojnë studimet në programet e masterave shkencorë në fushën e mësuesisë, psikologjisë së edukimit, punës sociale dhe edukimit fizik në referencë me Komizën Shqiptare të Kualifikimeve, Ligji nr. 10 247, niveli 5 – 8, që përfshin kualifikimet nga niveli bachelor deri në doktoraturë. Projekti u ofron mundësi profesionistëve në distancë lehtësisht të aksesueshme me UE për ndjekjen e studimeve të doktoratës pa shkëputje në puna, përfshi këtu edhe stafin akademik me kohë të pjesshme të angazhuar pranë FSHE-së dhe UE-së, të cilët aktualisht përbëjnë një përqindje të konsiderueshme të kontributit në procesin e mësimdhënies (*Shih* Figura 1.)

Shpërndarja e personelit akademik FSHE sipas titujve akademikë




Figure 1. Shpërndarja e personelit akademik FSHE sipas titujve akademikë

³² All European Academies (2018). Kodi Europian i sjelljes për integritet në kërkimin shkencor, Botim i rishikuar. Botim i Akademisë së Shkencave dhe e Studimeve Humane, https://www.allea.org/wp-content/uploads/2018/06/ALLEA-ALBANIAN-European-Codes-of-Conduct-for-Research-Integrity_FINAL.pdf

³³ http://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2018/07/KODI_ETIK.pdf





REPUBLIKA E SHQIPËRISE

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
FAKULTETI I SHKENCAVE TË EDUKIMIT

5. Metodologjia e projektit

Ndër llojet e metodologjive të zhvillimit të projekteve, metoda e shtegut kritik – critical path method/analysis³⁴ – shprehur këtu e në vazhdim me shkurtimin (CPM), u adoptua si më e përshtatshme, pasi a) e ndan projektin sipas llojit të punës ose aktiviteteve, b) përcakton kohëzgjatjen e fazave për realizimin e aktiviteteve duke analizuar që në fillim kohën totale për zhvillimin e plotë të projektit. Metodologjia CPM bën të mundur: 1) identifikimin e detyrave më të rëndësishme, 2) përcaktimin e afateve kohore të qarta dhe 3) krahasimin midis objektivave të planifikuara dhe atyre aktuale. Metodologjia e projektit paraqitet përmes diagramës *Shih* Fig.2.

³⁴ Project Management Institute (2017). *A guide to the Project Management Body of Knowledge (PMBOK® Guide)* (7th ed.). Project Management Institute.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI" FAKULTETI I SHKENCAVE TË EDUKIMIT

6. Bazat për integrimin e kërkimit në shkencat e edukimit

Përputhja me strategjinë e zhvillimit të arsimit 2021-2026

Projekti "Integrimi ndërsisiplinor i edukimit në shkencat e kërkimit" synon hapjen e programit të doktoratës në shkencat e edukimit në FSHE, është në linjë me Ligjin Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Draft-Strategjia Kombëtare e Arsimit 2021-2016 e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Rinisë në Republikën e Shqipërisë, Statutin e Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" (2018), dhe Rregulloren e Organizimit dhe Funkcionimit të Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" (2020).

Sipas Ligjit Nr. 80/2015, universiteti si institucion i arsimit të lartë ofron programe studimi në të gjitha ciklet, punë kërkimore dhe veprimtari krijuese. UE është afirmuar tashmë si një IAL e orientuar drejt kërkimit, aktualisht ofron programe të ciklit të tretë të studimeve në shkencat albanologjike dhe ato teknike mjekësore. Infrastruktura e kërkimit shkencor në UE përfshin dy qendra, Qendra e studimeve albanologjike dhe ballkanologjike "Aleks Buda", krijuar që në vitin 2011, pranë Fakultetit të Shkencave Humane, Qendra për kërkim dhe zhvillim në edukim në FSHE, 2015, të cilat mbështesin dhe nxitin kërkimin shkencor ndërsisiplinor. Projekti ndërtohet mbi qëllimet e Strategjisë për arsimin 2021-2026 (MAS, 2021, f. 8), respektivisht qëllimi (C) për një arsim të lartë gjithëpërfshirës që plotëson standardet ndërkombëtare të cilësisë, integritetit akademik e transparencës, dhe është promotor i zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të vendit. Është në linjë me objektivat specifike për ndërlidhjen më të mirë të arsimit të lartë me tregun e punës (Objektivi specifik C3) dhe për ndërkombëtarizimin e arsimit të lartë në Shqipëri dhe integrimin në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë (EHEA) (Objektivi specifik C6).

Sipas ISCED (2011, f. 59) programet e studimit të nivelit 8, të doktoraturës ose ekuivalente me të, hartohen me qëllimin primar për të drejtuar kualifikimin e avancuar në sferën e kërkimit. Programet e studimit të këtij niveli i dedikohen studimeve të avancuara dhe kërkimit origjinal dhe tipikisht ofrohen nga insitucione edukative të cilat i kushtojnë drejt kërkimit siç janë universitetet. Projekti





REPUBLIKA E SHQIPËRISE

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
FAKULTETI I SHKENCAVE TË EDUKIMIT

"Integrimi ndërdisiplinor i kërkimit në shkencat e edukimit" është në linjë me Klasifikimin Standard Ndërkombëtar të Edukimit (ISCED-F, 2013: Fields of education and training: Detailed field descriptions)³⁵ që njeh programet ndërdisiplinore në edukim.

7. ORGANIZIMI I STUDIMEVE DOKTORALE

Studimet e doktoraturës ndërtohen mbi programe individuale për aftësim të pavarur të kandidatëve në kërkimin shkencor në fushat e përcaktuara nga njësia bazë ose njësia kryesore. Ato kanë në themel kërkimin shkencor dhe veprimtarinë krijuese nga viti doktoral, do të realizohet duke patur parasysh kohëzgjatjen 3 -5 vjet si në vijim.

Elementet e planit vjetor të programit të studimit të doktoratës bazuar në projektin kërkimor-shkencor dhe zhvillimit të financuar të njësisë bazë.

Programi i ciklit të tretë të studimit: Doktoraturë në Shkenca Edukimi

³⁵ <http://uis.unesco.org/sites/default/files/documents/international-standard-classification-of-education-fields-of-education-and-training-2013-detailed-field-descriptions-2015-en.pdf>





REPUBLIKA E SHQIPËRISE

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
FAKULTETI I SHKENCAVE TË EDUKIMIT

Viti		Elementët e planit vjetor (3 vite)				
I	Formimi teorik kërkimor shkencor	Pjesëmarrje në konferenca	Aktivitete specifike mbi metodologjinë e kërkimit shkencor	Asistencë në mësimdhënie lidhur me fushën e kërkimit	Shqyrtimi i literaturës	Hartimi i planit të projektit të kërkimit ku të përfshihen të paktën qëllimi, metodat e kërkimit, burimet e nevojshme dhe rezultate të pritshme.
II	Përmirësim/ndryshim i planit të projektit shkencor ose fillimi i tij nëse është miratuar nga komisioni përkatës	Aktivitet në institucione (shkolla dhe institucione të tjera) sipas fokusit të kërkimit	Publikime shkencore mbi gjejet nga literatura	Zbatimi i projektit	Shqyrtim i literaturës dhe analiza statistikore	
III	Shkrimi i disertacionit	Pjesëmarrje në aktivitete shkencore (konferenca seminare) me interes në fushën kërkimore	Prezantimi i punimeve department	Përfundimi i disertacionit dhe detyrimeve të tjera doktorant	Dorëzimi i disertacionit në komision, mbrojtja e tezës.	





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
FAKULTETI I SHKENCAVE TË EDUKIMIT

Elementët e planit vjetor 5 vite					
Viti	Formimi teorik kërkimor shkencor	Pjesëmarrje në konferenca	Aktivitete metodologjinë e kërkimit shkencor	specifike mbi kërkimit shkencor	Asistencë në mësimdhënie lidhur me fushën e kërkimit
II	Shqyrtim i literaturës			Hartimi i planit të projektit të kërkimit ku të përfshihen të paktën qëllimi, metodat e kërkimit, burimet e nevojshme dhe rezultate të pritshme.	
III	Përmirësim/ ndryshim i planit të projektit shkencor ose fillimi i tij nëse është miratuar nga komisioni përkatës	Aktivitet në institucione (shkolla dhe institucione të tjera) sipas fokusit të kërkimit		Publikime shkencore mbi gjetjet literatura	Analiza statikore
IV	Zbatimi i projektit	Aktivitet në institucione (shkolla dhe institucione të tjera) sipas fokusit të kërkimit		Shqyrtim i literaturës	Shkrimi i disertacionit
V	Shkrimi i disertacionit	Pjesëmarrje në aktivitete shkencore (konferenca seminare) me interes në fushën kërkimore		Prezantimi në punimeve department	Përfundimi i disertacionit dhe detyrimeve të tjera si doktorant
					Dorëzimi i disertacionit në komision, mbrojtja e tezës.





REPUBLIKA E SHqipërisë

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
FAKULTETI I SHKENCAVE TË EDUKIMIT

8. PRODUKTE TË PROJEKTIT DHE AKTIVITETE TË LIDHURA ME PROJEKTIN

Ky projekt do të mundësojë çeljen për herë të parë dhe funksionimin e programit të doktoratës në shkencë edukimi në Universitetin e Elbasanit, por edhe më gjerë. Programi i doktoratës në shkencë edukimi është produkti kryesor i këtij projekti.

Përmes zhvillimit të projekteve kërkimore individuale, do të synohet të kuptohen dhe t'u jepen zgjidhje sfidave aktuale dhe atyre në të ardhmen që lidhen me sistemin arsimor, politikat e zhvillimit të arsimit, zhvillimin e kurrikulave në edukimin formal dhe joformal, vlerësimin e metodologjive të mësimdhënies, zbatimin e praktikave më të mira në mësimdhënie dhe kërkim etj. Projekti, synon gjithashtu zhvillim të kapaciteteve në hartimin dhe aplikimin e projekteve kërkimore.

Përgatitja e studiuve dhe kërkuesve në fushën e edukimit që do të mundësojnë ekspertizë akademike në arsimin e lartë, përgjatë hartimit të politikave arsimore në Shqipëri, kontribut në përmirësimin e kurrikulës në arsimin parauniversitar, në institucionet kërkimore të vendit dhe në drejtoritë dhe zyrat arsimore vendore është një tjetër produkt i rëndësishëm i projektit.

Doktoranti do të ketë realizuar si autor i parë ose i dytë, kur autori i parë është udhëheqësi shkencor, së paku 3 referime, 2 nga të cilat të jenë mbajtur në veprimtari shkencore ndërkombëtare (konferencë, simpozium, kongres), në një nga vendet e BE-së, OECD-së ose G20-ës, të pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe të botuara në "Proceedings", të indeksuar me kod ISBN ose ISSN. Doktoranti, do të ketë botuar së paku 3 artikuj shkencorë, nga të cilët 1 të jetë botuar ose pranuar për botim në revista shkencore të rankuara në Journal Citation Reports ose Scopus, ku është, së paku, autor i dytë.

Aktivitetet e lidhura me projektin do të jenë të ndara në tri faza. Faza e parë është faza para implementimit të projektit, ku në fokus do të jenë aktivitetet promovuese dhe prezantimi i programit të doktoratës, nëpërmjet seanceve të hapura të informimit si dhe duke shfrytëzuar edhe mundësitë e tjera të promovimit. Kjo fazë synon të bëjë të njohur dhe të prezantojë për të gjithë të interesuarit





REPUBLIKA E SHQIPËRISE

UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI” FAKULTETI I SHKENCAVE TË EDUKIMIT

programin e doktoratës si dhe t'i përgjigjet nismave të secilit kandidat potencial për të ndjekur programin. Përzgjedhja e kandidatëve bëhet në përputhje me kriteret për praninë dhe pikëzimin e dosjes së secilit aplikant, ku pjesën më të rëndësishme të aplikimit e ze propozimi i tezës doktorale.

Faza e dytë, është faza e studimeve doktorale, e cila fillon me fitimin e statusit të doktorantit, ku studenti ndjek programin individual të studimeve, referuar projektit kërkimor shkencor të paraqitur nga ai. Gjatë kësaj kohe, doktoranti është i përfshirë në aktivitetet kërkimore-shkencore të institucionit si dhe në aktivitetet kërkimore shkencore jashtë vendit.

Faza e tretë, është e lidhur me promovimin dhe integrimin në marrëdhëniet e punës së doktorantëve. Promovimi do të realizohet nëpërmjet pjesëmarrjes si organizatorë të konferencave të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare, të organizuara nga FSHE.

9. ANALIZA SWOT

Nëpërmjet përcaktimit të dy elementëve të saj (Strengths, Opportunities). Analiza SWOT na orienton se sa jemi në gjendje dhe të aftë të plotësojmë dhe të arrijmë objektivat e vendosura në këtë projekt, duke u mbështetur në anët tona të forta dhe në mundësitë që na krijohen nga situata të ndryshme.

Ndërsa nëpërmjet përcatimit të dy elementëve të tjerë (Weaknesses, Threats) Analiza SWOT na tregon pengesat të cilat duhet të kapërcehen ose duhet të minimizohen për të arritur rezultatet e dëshiruara për realizimin e projektit të doktoraturës.

Analiza SWOT në kuadër Fakulteti, na shërben për dy arsye kryesore:

- a. Për të marrë vendime se çfarë duhet të bëjmë më mirë
- b. Për të parashtruar problemet e zhvillimit në perspektivë në mënyrë realiste.

Në tabelën (1) të mëposhtme paraqiten **Strengths -Pikët e Forta** të Fakultetit të Shkencave të Edukimit /Universitetit “Aleksandër Xhuvani” Ebasan:





REPUBLIKA E SHQIPËRISE

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
FAKULTETI I SHKENCAVE TË EDUKIMIT

Tabela 1: Pikat e forta

Nr.	STRENGTHS (PIKAT E FORTA)
1	Reputacioni pozitiv në rajon në fushën e Mësuesisë
2	FSHE/UE ka traditë të gjatë dhe trashëgimi akademike në mësimdhënie në lidhje me përgatitjen e specialistëve dhe profesionistëve në fushën e Mësuesisë
3	Diversiteti i cikleve të studimit reflektuar në një ofertë të larmishme programesh
4	Infrastrukturë mësimore moderne
5	Potencial i lartë intelektual i stafit akademik; Cilësia, formimi dhe eksperiencia akademike e stafit brenda dhe jashtë vendit, niveli i kualifikimit në rritje, vërtetuar me gradat e titujt e fituar, garantojnë realizimin e kërkimit shkencor të vazhduar
6	FSHE/UE është lider për përgatitjen në nivelet më të larta të mundshme të mësuesve të rinj dhe specialistëve të tjerë në fushën e arsimit, shërbimit social dhe atij psikologjik, si dhe në trajnimin e mësuesve në shërbim
7	Trend gjithmonë e në rritje për këtë program studimi
8	Fakultet që adreson nevojat arsimore, sociale dhe psikologjike të shoqërisë përmes kërkimit shkencor ndërdisiplinor dhe edukimit në vazhdimësi
9	Metoda mësimdhënieje bashkëkohore bazuar në standardet europiane të arsimit të lartë
10	FSHE ka kapacitete infrastrukturore në lidhje me mjediset dhe laboratorët e vënë në dispozicion për realizimin e projekteve shkencore. Mjedise moderne dhe pajisje didaktike të standarteve ndërkombëtare
11	E inkuadruar në FSHE është edhe QKZHE, e cila do të ofrojë gjithashtu këshillimin dhe materiale të pasura në shërbim të programit
12	Shërbim cilësor në mësimdhënie nga stafi akademik i motivuar
13	Shërbime cilësore nga stafi ndihmës dhe mbështetës
14	Bibliotekë dhe salla studimi me hapësira të bollshme studimi dhe literaturë bashkëkohore .JSTORE
15	Marrëveshje bashkëpunimi me institucione të cilat ofrojnë mbështetje për studimet shkencore në kuadër të projektit.
16	Respektimi i vlerave reciproke staf akademik - student doktorant dhe çikës në komunikim





REPUBLIKA E SHOIPËRISE

UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”
FAKULTETI I SHKENCAVE TË EDUKIMIT

17	Përthithja e nivelit më të mirë të konkurrenteve, nga Shqipëria dhe trevat shqipfolëse, sipas kriterëve konkurruese.
18	Ekspertencë mësimdhënëse e stafit akademik në universitete europiane dhe botime ndërkombëtare

Në tabelën (2) paraqiten **Weaknesses-Dobësitë** të Fakultetit të Shkencave të Edukimit/Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”:

Tabela 2: Dobësitë

Nr	WEAKNESSES (DOBËSITË)
1	Mungesë financiare në mbështetjen e realizimit të projekteve shkencore
2	Mungesa e studimeve kombëtare mbi edukimin
3	Mungesa e studimeve të mirëfillta në lidhje me tregun e punës
4	Mungesë e një programi doktorature në Shkenca edukimi

Në tabelën (3) të mëposhtme paraqiten **Opportunities – (Mundësitë)** Fakultetit të Shkencave të Edukimit/Universitetit “ Aleksandër Xhuvani” Elbasan:

Tabela 3 : Mundësitë

Nr.	OPPORTUNITIES – (MUNDËSITË)
1	Përfshirja në projekte dhe programe të ndryshme në nivel European. Rritja e efektivitetit të bashkëpunimit kombëtar dhe ndërkombëtar në studime dhe kërkim shkencor; pasurimi i ekspertencës ndërkombëtare nëpërmjet pjesëmarrjes në shkëmbime universitare me programet Erasmus+, Horizon 2020 etj.
2	Përfshirje në projekte të ndryshme të MAS që lidhen me problematikën e zhvillimit të arsimit të lartë në Shqipëri.
3	Zhvillimi i konferencave dhe debateve shkencore.
4	Botime të shumta shkencore në organin periodik të Universitetit (Buletini shkencor)
5	Integrimi dhe përsosja e bashkëpunimit me institucionet shtetërore, organizatat jo qeveritare dhe institucionet e tjera të fushës së Mësuesisë.





REPUBLIKA E SHQIPËRISE

**UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”
FAKULTETI I SHKENCAVE TË EDUKIMIT**

Në tabelën (4) të mëposhtme paraqiten **Threats – (Kërcënimet)** për Fakultetin e Shkencave të Edukimit/ Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”:

Tabela 4 : Kërcënimet

Nr.	THREATS - KËRCËNIMET
1	Konkurrenca ndërmjet IAL-ve publike dhe private- programe të ngjashme të studimit të ofruara nga IAL publike apo private brenda vendit mund të jenë një alternative për studentët e nivelit të tretë të studimeve
2	Tarifat e shkollimit do të merren përsipër nga vetë doktoranti sipas përcaktimeve në vendimet përkatëse të Bordit të Administrimit të Universitetit të Elbasanit.

ANALIZA E TREGUT TË PUNËS

10. Analiza e tregut të punës

Edukimi terciar që ofrohet nga universitetet dhe institucionet e tjera të arsimit të lartë, luan një rol të rëndësishëm në shoqëri në nxitjen e inovacionit, zhvillimit dhe rritjes rekonomike, si dhe përmirësimin të mirëqenies së përgjithshme të qytetarëve të saj³⁶. Studiues dhe analistë parashikojnë se në vitet e ardhshme do të rritet kërkesa për njerëz shumë të kualifikuar ose me nivel të lartë të kualifikimit. Në shoqërinë e sotme për arsye të ritmeve të zhvillimit, teknologjisë, reformave zhvillimore në një vend etj., vendet e punës po bëhen gjithmonë e më komplekse dhe më fleksibël. Kjo ka bërë që punëdhënësit të kërkojnë staf me kapacitetet e nevojshme për të menaxhuar të dhëna dhe informacione komplekse, për të menduar në mënyrë autonome dhe kreative, për të përdorur burimet në mënyrë të zgjuar dhe efçente, për të komunikuar në mënyrë efektive dhe të pajisur me kompetenca të mjaftueshme dhe aftësi për t'u

³⁶ Eurostat (2021). *Education and training in the EU: Facts and figures*, gjykuar më 19/11/2022 në https://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php?title=Education_and_training_in_the_EU_-_facts_and_figures





REPUBLIKA E SHQIPËRISE

UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI” FAKULTETI I SHKENCAVE TË EDUKIMIT

adaptuar ndaj rrethanave të ndryshueshme³⁷. Për arsytet si më lart, programet interdisciplinore në edukim janë më realiste në kontekstin e shoqërive të sotme.

Në Shqipëri dhe në vendet e rajonit, përqindja e studentëve doktoralë në raport me totalin e studentëve të regjistruar në arsimin terciar është shumë e vogël krahasuar me vendet evropiane ose me ato vende të ish Bllokut të Lindjes³⁸. Sipas një vlerësimi³⁹, 1.6% e studentëve në të gjitha nivelet e studimit universitar ndjekin studimet në doktoraturë. Shpjegimi i shifrave kërkon studime të detajuara të evidentimit të faktorëve pengues ose shtrëngues. Megjithatë analiza faktike e numrit të studentëve të regjistruar në programet e studimeve të doktoratës në vendin tonë përgjatë viteve shënon rritje (INSTAT, 2020)⁴⁰, gjë që është tregues i interesit dhe ambicjes së të diplomuarve shqiptarë për zhvillim profesional dhe personal. Shqipëria karakterizohet nga numri i madh i studentëve të regjistruar në edukimin terciar që reflektohet në statistikat evropiane përgjatë viteve të fundit, p.sh., nga viti 1999/2000 deri në 2016/2017, rritja në përqindje e rendit atë të tretën pas Turqisë dhe Qipros me 200%. Vetëm për periudhën 2010-2015, Shqipëria dhe Danimarka ishin vendet me rritje më të lartë të përqindjes në numrin e studentëve me 30% pas Turqisë⁴¹. Shifrat mbështeten edhe nga gjetjet e Anketës së Arsimit të Rriturve (INSTAT, 2018)⁴², ku arsyeja kryesore e pjesëmarrjes në arsimin jo-zyrtar për grupmoshën 25 – 64 vjeç me arsim të lartë përfshinte përmirësimin e aftësive në vendin e punës, p.sh., “Për të kryer punën time sa më mirë”, “Për të rritur njohuritë/aftësitë e mia në një fushë që më intereson”. Rëndësia e arsimit të lartë nuk qëndron vetëm në aspektin e zhvillimit ekonomik të një vendi, por edhe në mbështetjen ndaj zhvillimit personal dhe social të çdo individi.

³⁷ Po këtu

³⁸ Po këtu

³⁹ Grupi i Punës për hapjen e programit të Doktoraturës, FSHE (2021).

⁴⁰ http://www.instat.gov.al/media/8334/statistika-te-diplomimeve_2019-20_juna-formuar

⁴¹ Education, Audiovisual and Culture Executive Agency (2020). *The European Skills and Education Monitor in 2020: Bologna process implementation report*, Luxembourg: Publications Office of the European Union.

⁴² <http://www.instat.gov.al/media/3991/rezultatet-e-anketes-se-arsimit-te-territive>





REPUBLIKA E SHQIPËRISE

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI" FAKULTETI I SHKENCAVE TË EDUKIMIT

Studiues dhe analistë të arsimit të lartë (p.sh., Scott, 2000⁴⁵) në Evropë konstatojnë se shkalla e rindërtimit të arsimit të lartë pas vitit 1999 në Evropën Lindore ka qenë e një ritmi të paprecedent krahasuar me vendet e Evropës perëndimore, duke e shndërruar universitetin në një ofrues produktesh tërheqës për të rinjtë⁴⁶, të cilët janë më pranë korrenteve shkencore inovative dhe atyre ideologjike si dhe ndryshimit të pririjeve në tregun e punës⁴⁷. Të rinjtë në Evropën Lindore përbëjnë konsumatorët më të mëdhenj të arsimit të lartë krahasuar me Evropën Perëndimore. Një ndër arsytet është kërkesa e lartë në ato vende pune që renditen si "shërbime"⁴⁸. Vihet re një lidhje midis rritjes së kapaciteve ose aftësive në punë dhe mundësive më të mëdha për t'u punësuar në administratë, mbështetur kjo edhe nga statistikat e punësimit në vendin tonë, ku numrin më të lartë të të punësuarve në administratë e zënë specialistët⁴⁹.

10.1 Përputhja me vizionin e zhvillimit të FSHE-së

Studiues dhe analistë të arsimit të lartë në Evropë (p.sh., Scott, 2000⁵⁰) konstatojnë se shkalla e rindërtimit të arsimit të lartë pas vitit 1999 në Evropën Lindore ka qenë e një ritmi të paprecedent krahasuar me vendet e Evropës perëndimore, duke e shndërruar universitetin në një ofrues produktesh tërheqës për të rinjtë⁵¹, të cilët janë më pranë korrenteve shkencore inovative dhe atyre

⁴⁵ Scott, P. (2010). Reflection on the reform of higher education in Central and Eastern Europe, *The Routledge International Handbook of Higher Education*, f. 269.

⁴⁶ OECD (2010). *Education at a glance: OECD Indicators*, Paris: OECD Publishing.

⁴⁷ Kogan, I. (2012). Tertiary education landscape and labour market chances of the highly educated on central and eastern Europe, *European Sociological Review*, Vol. 28, No. 6, f. 701-703.

⁴⁸ Mysikova, M., Vecernik, J. (2018). Returns to tertiary education in Western and Eastern Europe, *Prague Economic Papers*, Vol. 28, No. 1, f. 30-48.

⁴⁹ INSTAT (2020). Të punësuar në sektorin shtetëror sipas grupeve kryesore të profesioneve, 2016-2020 <http://www.instat.gov.al/temat/trecgu-i-pun%C3%ABs-dhe-arsimi/i%C3%AB-dh/%C3%AB-administrative-i%C3%AB-tregut-i%C3%AB-pun%C3%ABs/#tab2>

⁵⁰ Scott, P. (2010). Reflection on the reform of higher education in Central and Eastern Europe, *The Routledge International Handbook of Higher Education*, f. 269.

⁵¹ OECD (2010). *Education at a glance: OECD Indicators*, Paris: OECD Publishing





REPUBLIKA E SHQIPËRISE

UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI” FAKULTETI I SHKENCAVE TË EDUKIMIT

ideologjike si dhe ndryshimit të prirejeve në tregun e punës⁵². Të rinjtë në Evropën Lindore përbëjnë konsumatorët më të mëdhenj të arsimit të lartë krahasuar me Evropën Perëndimore. Një ndër arsytet është kërkesa e lartë në ato vende pune që renditen si “shërbime”⁵³. Vihet re një lidhje midis rritjes së kapaciteve ose aftësive në punë dhe mundësive më të mëdha për t’u punësuar në administratë, mbështetur kjo edhe nga statistikat e punësimit në vendin tonë, ku numrin më të lartë të të punësuarve në administratë e zënë specialistët⁵⁴.

10.2 Përputhja me vizionin e zhvillimit të FSHE-së

Edhe pse arsimit i lartë po ndryshon me ritme të shpejta, jo rrallëherë konfuze midis dikotomisë aktuale të modeleve të zhvillimit të universiteteve (Humboldtiane apo të orientuar drejt tregut), historiku dhe tradita mund të shërbejnë si pika mbështetje të ndërtimit të vizionit për të ardhmen. Fakulteti i Shkencave të Edukimit në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” është ndër IAL-të e vetme në vend që bazohet në një traditë më shumë se njëqind vjeçare në zhvillimin e arsimit dhe formimit profesional të mësuesve. Aktualisht numëron dhjetëra programe (*Shih* seksionin “Përshkrimi i institucionit”) të nivelit bachelor dhe master në mësuesi, psikologji dhe shkencë sociale që formojnë mësues, edukatorë në sistemin arsimor parauniversitar (SAPU) dhe profesionistë në shërbimet sociale dhe të edukimit jorformal. Akumulimi i praktikës më të mirë në mësimdhënie, paralelisht me thellimin e hulumtimit në teoritë dhe proceset rreth edukimit e sjell atë në një momentum të zgjerimit të natyrshëm në ofrimin e ciklit III të studimeve të larta dhe konsolidimit të saj si një institucion kërkimi. Edhe pse kërkimi shkencor në IAL-të shqiptare nuk është në nivelin e IAL-ve evropiane dhe ato të rajonit, mund të jetë pasojë e nismave të fragmentarizuara bazuar në punën individuale të pedagogëve e jo aktivitetit i integruar dhe i mirëinstitucionalizuar (MAS, 2021)⁵⁵. Projekti paraqet një nismë për tejkalimin e situatës kërkimore ekzistuese duke adoptuar interdisiplinore të kërkimit përmes sinergjisë në produktet e deritanishme të kërkimit, potencialeve

⁵² Kogan, I. (2012). Tertiary education landscape and labour market chances of the high-tech nations in central and eastern Europe, *European Sociological Review*, Vol. 28, No. 6, f. 701-703.

⁵³ Mysikova, M., Vecernik, J. (2018). Returns to tertiary education in Western and Eastern Europe, *European Economic Papers*, Vol. 28, No. 1, f. 30-48.

⁵⁴ INSTAT (2020). Të punësuar në sektorin shtetëror sipas grupeve kryesore të profesioneve 2016-2020. <http://www.instat.gov.al/al/temat/tregu-i-pun%C3%ABs-dhe-arsimi/%C3%AB-dh%C3%AB-administrative-%C3%AB-egj%C3%AB-um%C3%ABs/#tab2>

⁵⁵ MASR (2021). *Strategjia Kombëtare e Arsimit 2021-2026*: Draft, Tiranë: Autori





REPUBLIKA E SHQIPËRISE

UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI” FAKULTETI I SHKENCAVE TË EDUKIMIT

dhe kapaciteteve të kërkimit nga akademikë dhe studiues të disiplinave të ndryshme nëpër departamentet pjesë përbërëse të FSHE-së. Një projekt i tillë krijon terrenin për integrimin e punimeve të studentëve me punën e vazhdueshme kërkimore në universitet (Vula et al., 2012)⁵⁶ dhe kontribuon në terma afatgjatë në fuqizimin e projekteve kërkimore të qëndrueshme bazuar në veprimtarinë e grupeve të përbashkëta të kërkimit.

Tradita e UE-së në trajnimin profesional të mësuesve, reflektohet në angazhimin e tij përkundrejt rritjes së vazhdueshme profesionale së mësuesve, që përbën faktorin më impaktin më të madh në cilësinë e edukimit ose arsimit ofruar brezave të rinj. Përmes projektit sigurohet vazhdimësia e zotimit historik ndaj mësuesve, të cilët njëkohësisht përbëjnë një prej “konsumatorëve” më besnikë të programeve të studimit në UE, përmes mundësisë për zhvillimin e kapaciteteve të tyre kritike dhe krijuese në kërkim empirik dhe bazuar në praktikë (practice-based research). Shumica e mësuesve në Shqipëri dëshirojnë të arrijnë një ndikim përmes ushtrimit të profesionit si një mënyrë përmes të tjerash, për të rivendosur vlerësimin e përshtatshëm shoqëror të figurës së mësuesit (ETF, 2019)⁵⁷ të cënuar në dekadat e fundit nga proceset reformuese dhe modernizuese në sistemin arsimor (Haxhiymeri & Mita, 2014⁵⁸; Whitehead, 2010⁵⁹), të cilat jo vetëm kanë sfiduar burimet e tyre të brendshme për të akomoduar në praktikën e tyre profesionale ndryshimet në kurrikula dhe teknologji të mësimdhënies, por nuk kanë siguruar ndërtimin e një imazhi të qëndrueshëm të mësuesit ai agjent edukues në shoqëri. Studimet doktorale në shkencat e edukimit u ofrojnë mundësinë edukatorëve, mësuesve dhe profesionistëve të tjerë të lidhur me edukimin, të thellojnë dijen e tyre rreth përmes adoptimit të metodologjive ose qasjeve shkencore në hulumtimin e problematikave që lidhen jo vetëm me procesin e mësimdhënies dhe të të mësuarit, por edhe të formimit apo zgjerimit të identitetit

⁵⁶ Vula, E., Saqipi, B., Karaj, A. T., & Mita, N. (2012). Moving towards practice-oriented and Research-Based teacher education: Challenges of Kosovo and Albania. *Excellence in Higher Education*, Vol. 3, No. 1, f. 37-45.

⁵⁷ European Training Foundation (2019). *Professional development of teachers in Albania*. Shërbimet e Europës, datuar më 11/12/2021 në <https://www.etf.europa.eu/en/news-and-events/news/professional-development-teachers-albania>

⁵⁸ Haxhiymeri E., Mita N., (2014). *Zhvillimi Profesional dhe Vlerësimi i Mësuesve në Shqipëri*. Kualicioni për Arsimin e Fëmijëve në Shqipëri, Tiranë.

⁵⁹ Whitehead, J. (2010). Teacher education reforms in Albania. *European Journal of Teacher Education*, Vol. 23, No. 1, f. 85-94.





REPUBLIKA E SHQIPËRISE

**UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”
FAKULTETI I SHKENCAVE TË EDUKIMIT**

profesional të mësuesit (Vula et al., 2012). Edukimi i mësuesve në vetvete përfaqëson një dije multidisiplinare, pasi mësuesit nuk mundën vetëm të zotërojnë një dije të thelluar të pedagogjisë, por edhe të kuptojnë dimensionet sociale dhe kulturore të edukimit.

Aktualisht në Fakultetin e Shkencave të Edukimit ka 1384 studentë në të gjitha programet e studimit si në tabelat më poshtë:

Në vitin 2020 janë diplomuar 782 studentë. Në vitin 2021 janë diplomuar 716 studentë.

Cikli i parë, Bachelor, me kohë të plotë

Nr.	Programi i studimit	Nr. i studentëve
1.	Bachelor në Mësuesi për Arsimin Parashkollor	31
2.	Bachelor në Edukim Fizik dhe Sporte	243
3.	Bachelor në Mësuesi për Arsimin Fillor	31
4.	Bachelor për Punonjës Social	125
5.	Bachelor për Psikologji	28
6.	Program profesional 2 vjeçar: Edukator për fëmijët 0-3 vjeç	125
8.	Bachelor në Filozofi – Sociologji	14

Cikli i dytë, Master profesional, me kohë të plotë

Nr.	Programi i studimit	Nr. i studentëve
1.	Master Profesional në Mësuesi në AMU për Matematikë-Fizikë me profil-minor në Informatikë	41
2.	Master Profesional në Mësuesi në AMU për Matematikë-Informatikë me profil-minor në Fizikë	21
3.	Master Profesional në Mësuesi në AMU për Biologji-Kimi me profil-minor në Edukim Shëndetësor dhe	47



REPUBLIKA E SHQIPËRISE

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
FAKULTETI I SHKENCAVE TË EDUKIMIT

Mjedisor		
4.	Master Profesional në Mësuesi në AMU për Gjuhë Shqipe dhe Letërsi	43
5.	Master Profesional në Mësuesi në AMU për Gjuhë e huaj Angleze me profil minor Gjuhë Shqipe	68
6.	Master Profesional në Mësuesi në AMU për Edukatë Qytetare-Histori me profil minor në Gjeografi	32
7.	Master Profesional në Mësuesi në AMU për Histori-Gjeografi me profil minor në Edukatë Qytetare	67
8.	Master Profesional në Drejtim dhe administrim arsimit	24
9.	Master Profesional në Psikolog në Institucione	10
10.	Master Profesional në Shërbim Prove	13
11.	Master Profesional në Punonjës social me fëmijët dhe familjen	13
12.	Master Profesional në Edukim Fizik dhe Sporte me profil minor në edukim shëndetësor	124
13.	Master Profesional në Mësuesi në AMU për Gjuhë e huaj gjermane me profil minor në Gjuhë Shqipe	11
14.	Master Profesional në Mësuesi në AMU për "Gjuhë e huaj frënge me profil minor Gjuhë Shqipe	6
15.	Master Profesional në Mësuesi në AMU për Edukatë Qytetare-Gjeografi me profil minor në Histori	11
16.	Master Profesional për Arsimit special	68

Cikli i dytë, Master i Shkencave, me kohë të plotë

Nr.	Programi i studimit	Nr. i studentëve
1.	Master i Shkencës në Mësuesi per Arsimin Fillor	112
2.	Master i Shkencave në Psikologji Edukimi	22
3.	Master i Shkencave në Shërbime Sociale	52



UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
FAKULTETI I SHKENCAVE TË EDUKIMIT

10.3 Mbështetja në projekte kërkimore dhe zhvillimore të FSHE-së

Afirmimi i FSHE-së si një njësi qendrore e orientuar drejt kërkimit dhe zhvillimit të tij në të ardhmen bazohet në përvojat, kapacitetet njerëzore të kërkimit, iniciativat kreative dhe burimet fizike në mbështetje të kërkimit.

FSHE ka qenë pjesëmarrës në projekte kërkimore ndërkombëtare si vijon:

TEAVET (Developing Teacher Competencies for a Comprehensive VET system in Albania), financuar nga programi Erasmus+ me partnerë tri universitete ndërkombëtarë, tetë IAL kombëtare dhe MASR, Kohëzgjatja: 2018 – 2021. Projekti synonte mbështetjen e edukimit në vazhdimësi të mësuesve ose të mësuarit përgjatë fazave të ndryshme të karrierës.

LECU (Learning Cultures in University) përfaqëson një rrjet ndërkombëtar lektorësh nga fakultetet që përgatisin mësues dhe përfaqësues nga ministritë e Arsimit të tri vendeve: Zvicra, Shqipëria dhe Kosova, Kohëzgjatja: 2018 – 2021. Qëllimi i projektit përfshinte mësimdhënien bazuar në kompetenca në arsimin e lartë.

Arsimi Gjithëpërfshirës në Shqipëri, projekt i iniciuar nga Save the Children me bashkëpunimin e tri Universiteteve: i Bolonjës, i Elbasanit dhe i Korçës, Kohëzgjatja: 2015 – 2021. Projekti synoi rishikimin e kurrikulave ekzistuese të përgatitjes së mësuesve në arsimin parashkollor dhe atë fillor, hartimin e një udhëzuesi praktik për realizimin e planit edukativ individual (PEI) nga grupi multidisiplinor në shkollë në kuadër të arsimit gjithëpërfshirës. Produkti i projektit ishte zhvillimi i programit të studimeve Edukator për Fëmijët 0 – 3 vjeç dhe programi Master në Mësuesi për Arsimin Special.

T@SK (Towards Increased Awareness, Responsibility And Shared Quality In Social Work), projekt i financuar nga Programi Erasmus + Capacity Building in Higher Education dhe Bashkimi Evropian Kohëzgjatja: 2018 – 2020. Projekti T@SK u financua nga programi i Bashkimit Evropian ERASMUS+ për ngritjen e kapaciteteve. Qëllimi ishte zhvillimi dhe modernizimi i ofrimit të shërbimeve sociale në Shqipëri përmes fuqizimit të sistemit të arsimit të lartë shqiptar me synimin e orientimit të cilësisë së shërbimeve sociale sipas standardeve evropiane. Partnerët ndërkombëtarë përfshinë Universitetin e Firences, Itali, Universitetin




UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI” FAKULTETI I SHKENCAVE TË EDUKIMIT

Complutense të Madridit, Spanjë, Institutin Universitar të Lisbonës, Portugali dhe Urdhri i Punonjësve social të Rajonit të Toskanës, Itali, ndërsa partnerët vendas përfshijnë Universitetet e Elbasanit, Tiranës dhe Shkodrës. Projekti adresoi konkretisht a) përditësimin teorik dhe metodologjik të stafëve akademikë në universitetet shqiptare ku ofrohen programet e studimit bachelor dhe master në punën sociale, b) përfshirjen e punonjësve socialë shqiptarë dhe institucioneve vendore në identifikimin e nevojave të shërbimeve sociale vendase, c) rritjen e vëmendjes ndaj disa sektorëve të shërbimit social shtetëror që kanë të bëjnë me mbrojtjen, ndihmën dhe mbështetjen ndaj fëmijëve të deprivuar dhe grave në vështirësi . Faqja zyrtare e projektit <https://www.taskproject.eu/our-project/>, Kanali në Youtube <https://www.youtube.com/channel/UC98EMvWBwhNB8KA5DLKINng>, Përshkrimi i projektit në faqen zyrtare të Universitetit të Elbasanit <https://www.uniel.edu.al/bashkepunimi-nderkombetare-ue/projekte-ku-ue-eshte-pjese/597-1-sk-project-towards-increased-awareness-responsibility-and-shared-quality-in-social-work>

Botime në kuadër të projekteve

- Save the Children (2017). *Udhëzues praktik për hartimin dhe zbatimin e planit edukativ individual (PEI)*, Tiranë: Autori.
- The project T@SK (2020). *Social services in Albania: Background and state of the art: A report from Tërana, Shkoder and Elbasan*, Bari: Cacucci Editore.
- Osmanaj, E. (2019). *The right of education of Roma community in Albania*, Bari: Cacucci Editore.
- T@SK (2020). *Guidelines for the digitalization and management of the academic activities: ICT preparatory structuring guidelines for virtualizing education in social work*, https://www.taskproject.eu/wp-content/uploads/2019/01/WP1.3_Guidelines-ICT_FINAL.pdf
- T@SK (2020). *Teaching Guidelines: How to use ICT in teaching and learning activities*, https://www.taskproject.eu/wp-content/uploads/2019/01/WP1.3_Guidelines-2-ANNEX-I-Teaching-guidelines.pdf
- T@SK (2019). *Guidelines for the use of the ICT (Moodle) for students*, https://www.taskproject.eu/wp-content/uploads/2019/01/WP1.3_Guidelines-2-ANNEX-II-Moodle-Student%E2%80%99s-Brief-guidelines.pdf
- T@SK (2019). *Guidelines for the use of the ICT (Moodle) for teachers*, https://www.taskproject.eu/wp-content/uploads/2019/01/WP1.3_Guidelines-2-ANNEX-III-Moodle-Guidelines-for-Teachers.pdf



REPUBLIKA E SHQIPËRISE

UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”
FAKULTETI I SHKENCAVE TË EDUKIMIT

- T@SK (2019). *Guidelines for the new internship procedures in social work*, <https://play.google.com/books/reader?id=WsQWEAAAQBAJ&hl=it&pg=GBS.PPI>
 - T@SK (2020). *Handbook Social Work Education: Reflections and debate in the European context*, <https://play.google.com/books/reader?id=7CwXEAAAQBAJ&hl=it&pg=GBS.PPI>
- Konferencat dhe Kualifikimet Ndërkombëtare në kuadër të Projektit T@SK:**
- December 3rd 2020, Building bridges between university and society, https://www.taskproject.eu/wp-content/uploads/2019/01/FinalConferenceAgenda_LV.pdf
 - March 5th 2020, Strengthening the University's Partnership with social services institutions, https://www.taskproject.eu/wp-content/uploads/2019/01/Agenda_Round-Table_TASK_Logo_OK.pdf
 - 25th – 29th June, 2019, First Consolidation Training, <https://www.taskproject.eu/2019/05/08/first-consolidation-training-in-florence/>
 - 2nd – 6th December 2019, Second Consolidation Training, https://www.taskproject.eu/wp-content/uploads/2019/01/Lisbon_SCT_2-6december2019-1.pdf
 - 28th – 2nd October 2020, Third Consolidation Training (online), https://www.taskproject.eu/wp-content/uploads/2019/01/Agenda3CT_TASK-Madrid2020_ok.pdf

Konferenca ndërkombëtare të organizuara nga FSHE:

“Achievements and challenges of social work profession in Albania”, konferencë me bazë vjetore që prej vitit 2017, në bashkëpunim me Universitetin e Tiranës, Shkodrës, Barit, Firences, Madridit dhe atë të Lisbonës.

“Shkencat sportive, edukimi dhe roli i tyre në zhvillimin e qëndrueshëm dhe mirëqenien sociale”, konferencë me bazë vjetore që prej vitit 2016 në bashkëpunim me Shoqatën Shqiptare të Shkencave Sportive (ASSA).

“Globalization and integration in contemporary education”, konferenca I ndërkombëtare e fokusuar në shkencat e edukimit, në bashkëpunim me 11 universitete brenda dhe jashtë vendit, e cila shpallon të shndërrohet në një event të përvitshëm në





REPUBLIKA E SHQIPËRISE

UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI” FAKULTETI I SHKENCAVE TË EDUKIMIT

kuadër të projektit të iniciuar nga FSHE “Muaji i mësuesisë” dedikuar formimit dhe zhvillimit profesional të mësuesve, pedagogjise, didaktikës, të mësuarit etj.

Konferencat ndërkombëtare të rregullta u japin mundësinë studentëve doktorantë të publikojnë gjetjet e fazave të ndryshme të projekteve të tyre kërkimore. Paralelisht zhvillojnë aftësi të të shkruarit akademik, prezantimit dhe komunikimit apo shkëmbimit të dijes në mjedisin akademik.

Burime mbështetëse për kërkimin shkencor

FSHE ofron një infrastrukturë bashkëkohore të mësimdhënies dhe të të mësuarit fizik në auditor me bazë teknologjinë, dhe atë online, p.sh., Laboratori i ICT, financuar nga Projekti T@SK. Ambjentet e FSHE-së janë të pajisura me një server të dedikuar për ofrimin e internetit dhe wireless. Për mbështetjen e mësimdhënies ekzistojnë dy platforma të mësimdhënies dixhitale Moodle dhe TEAMS. Laboratori T@SK pranë Fakultetit të Shkencave të Edukimit ka në përmbërje të tij një infrastrukturë të pasur teknologjike për mësimdhënien në distancë, duke ofruar platformën Moodle. Moodle ose ndryshe Learning Management System është vënë në funksion në nëntor të Vitit 2019 për departamentin e Shkencave Sociale në Fakultetin e Shkencave të Edukimit. Është operuar në 64 module të ndara në 4 programe studimi, Bachelor dhe Master. 200 studentë aksesojnë në platformë në modulet e tyre përkatëse. <https://www.uniel.edu.al/fakultetet/fakulteti-i-shkencave-te-edukimit/veprimtari>

UE ka buletin e saj shkencor⁶⁰ boton punime origjinale që sjellin njohuri të reja dhe të rëndësishme për përpunimin e shkencës. Ky organ botues është krijuar me idenë fillestare të promovimit të gjetjeve shkencore të akademikëve shqiptarë brenda dhe jashtë mjedisit universitar shqiptar. Rëndësia e botimit të Buletinit qëndron në dhënien e mundësisë për të gjithë kërkuesit akademikë, të cilët sjellin gjetjet më të reja në fushat përkatëse të tyre si dhe përditësojnë në kohë gjetje të mëparshme.



⁶⁰ <https://www.uniel.edu.al/kerkimi-shkencor/buletini-shkencor/publikime-nc-vite>

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
FAKULTETI I SHKENCAVE TË EDUKIMIT

FSHE mundëson hapësira fizike të mjaftueshme për realizimin e kërkimit për studentët doktorantë, të cilat përfshijnë aktualisht bibliotekën, tri laboratorë të arteve figurative dhe të zbatuara, një laborator mësimdhënie përmes TIK-ut.

FSHE si agjenci trajnuese

Programi i trajnimit të detyrueshëm përgatitor për certifikim për drejtues të institucioneve të arsimit parauniversitar - FSHE në bashkëpunim me Qendrën Shkolla e Drejtorëve (CSL) prej tetorit 2020, program që synon formimin dhe rritjen profesionale të drejtuesve të institucioneve të arsimit parauniversitar përmes zhvillimit të aftësive menaxheriale dhe administrative. Në total 104 pjesëmarrës, drejtues aktualë të shkollave të sistemit arsimor parauniversitar apo mësues-aspirantë për drejtues (48 në Brezin e dytë dhe 56 në Brezin e tretë). Nëntë modulet e trajnimit ofrohen nga pedagogë të FSHE-së si dhe të FSHH-së dhe FSHN-së.

Seanca trajnuese për rritjen profesionale të mësuesve në bashkëpunim me IZHA, ku stafi akademik i UE-së janë trajnerë të moduleve (mesatarisht 20 të tilla), Vendim Nr. 2, datë 19.12.2017 "Për akreditimin e moduleve të trajnimit" në Fakultetin e Shkencave të Edukimit.

10.4 Konsiderata praktike

Natyra tradicionale e IAL-ve mund të krijojë barriera për interdisiplinartet, kultura organizative e të cilave mund të pengojë kërkuesit të bashkëpunojnë midis tyre. Synohet që projekti të iniciojë një proces edukues për të krijuar mjedise interdisiplinare për inkurajimin dhe lehtësimin e kërkimit, i.e. klima organizacionale, ndërveprimi kolegial dhe komunikimi konstruktiv që mundëson lëvizjen paradigmale – paradigëm shift. Ne besojmë se puna interdisiplinare dhe interdisiplinarteti do të ofrojnë kontribute të rëndësishme në analizën dhe të kuptuarit të sistemit arsimor. Një sistem arsimor është një realitet i gjallë, dinamik, ndonjëherë kontradiktor, por në thelb një *realitet plural*. Në një sistem demokratik, sistemi arsimor reflekton perspektiva të ndryshme politike, filozofike, kulturore, sociale dhe ekonomike. Është ky vitalitet që u jep mundësi subjekteve të edukimit, të kenë një rol aktiv dhe kritik ndaj sistemit. Edukimi shkon përtej sistemit arsimor apo atij të formimit profesional të mësuesve dhe edukatorëve, drejt një kuptimi të të mësuarit ose të përshatuarit ndaj rrethanave fizike, sociale, psikologjike, kulturore dhe politike, që ndodh në të gjitha kohërat dhe vendet, me



UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
FAKULTETI I SHKENCAVE TË EDUKIMIT

gjithçka dhe me të tërë. Ky është dhe kuptimi i konceptit të *shoqërisë së dijes*, një shoqëri që gjeneron, shpërmdan dhe mundëson dijen ndër gjithë anëtarët e shoqërisë në mënyrë që të përdoret për përmirësimin e gjendjes njerëzore (UNESCO, 2005)⁶¹.

11. GRUPI I PUNËS PËR IMPLEMENTIMIN E PROJEKTIT

NR.	GRADA/TITULLI	EMËR MBIEMËR	ANGAZHIMI
1.	Prof.dr	Skender Topi	Personel akademik
2.	Prof.dr.	Fatbardha Gjini	Personel akademik
3.	Prof.dr.	Xhevdet Zekaj	Personel akademik
4.	Prof.dr.	Pranvera Gjoci	Personel akademik
5.	Prof.as. dr.	Elisabeta Osmanaj	Personel akademik
6.	Prof.as. dr.	Alma Muhtarremi	Personel akademik
7.	Prof.as. dr.	Florinda Tarusha	Personel akademik
8.	Prof.as.dr.	Lindita Durmishi	Personel akademik
9.	Prof.as.	Bujar Kapllani	Personel akademik
10.	Dr.	Ardian Tana	Personel akademik
11.	Dr.	Roksana Poçi	Personel akademik
12.	Dr.	Armando Shëngjergji	Personel akademik
13.	Doc.Dr.	Beatrice Gani	Personel akademik
14.	MSc.	Alketa Boriçi	Personel ndihmës akademik: laborant
15.	MSc	Dorina Hasanllari	Specialist protokoll arkiv



⁶¹ United Nations Educational, Scientific and Cultural Organization (2005). *Toward knowledge societies*. UNESCO World Report, France: Imprimerie Corlet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISE

**UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”
FAKULTETI I SHKENCAVE TË EDUKIMIT**

12. TË DHËNA MBI KRITERET E PRANIMIT, TARIFA DHE MODALITETE FINANCIARE

12.1 Për të kryer regjistrimin e studimit të doktoratës kandidati duhet të plotësojë këto kritere:

- Të ketë përfunduar studimet e larta në shkencat e edukimit dhe të zotërojë një diplomë të ciklit të dytë “Master i Shkencave”/“Master i arteve”, një diplomë të integruar të nivelit të dytë, ose një diplomë sipas sistemit të vjetër apo titull akademik të barasvlefshëm, të fituar jashtë vendit dhe të njohur nga organet kompetente;
- Të ketë mesatare mbi 8 (tetë) në studimet e ciklit të parë dhe të dytë;
- Të ketë mbrojtur një nga gjuhët e huaja: anglisht, italisht, frëngjisht gjermanisht ose spanjisht në përputhje me nivelet e parashikuara në Udhëzimin nr. 52, datë 03.12.2015 “Për përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare, për pranimet në programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë në institucionet e arsimit të lartë”, të ndryshuar;
- Të ketë dy rekomandime nga persona që kanë titullin profesor, ose profesor i asociuar të cilët nohin aftësitë kërkimore-shkencore dhe profesionale të kandidatit;
- Të ketë paraqitur projektin kërkimor në përputhje me projektin *“Integrimi ndërdisiplinor i kërkimit në shkencat e edukimit”* në momentin e aplikimit;
- Të paraqesë një përmbledhje të temës së masterit (4 faqe) për studentët që e zotërojnë një diplomë të ciklit të dytë “Master i Shkencave”/ “Master i arteve”;
- Të ketë publikime të mëparshme kërkimore, shkencore;





REPUBLIKA E SHQIPËRISE

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI" FAKULTETI I SHKENCAVE TË EDUKIMIT

- Të mos jenë marrë masa disiplinore ndaj tij apo të mos jenë gjetur shkelje të rregullave të etikës së kërkimit shkencor, të të drejtave që burojnë nga pronësia intelektuale apo shkelje të rregullave kundër plagjiaturës, si dhe të vetëdeklarojë se është në gjendje të zbatojë standardet shkencore dhe etike.

Aplikanti për të ndjekur programin e studimit të doktoratës bën një kërkesë, ku paraqet edhe propozimin për temën dhe objektivat e kërkimit shkencor. Kjo kërkesë përfshihet në dosjen personale e cila përmban edhe dokumentet e mëposhtme:

- Curriculum Vitae (sipas formatit Europass)
- Kopje e noterizuar e diplomave, të shoqëruara me suplementet e diplomës ose listën e notave me kreditet përkatëse. Diplomat e fituara jashtë vendit duhet të shoqërohen me vërtetimin e njohjes/ekuivalentimit nga ministria përgjegjëse për arsimimin;
- Certifikatë lindjeje si dhe fotokopje të kartës së identitetit/ pashaportës;
- Dy rekomandime nga persona me titullin Profesor ose Profesor i Asociuar;
- Dëshmi të gujës së huaj në përputhje me nivelet e parashikuara në Udhëzimin nr. 52, datë 03.12.2015 "Për përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare, për pranimet në programet e ciklit të dytë dhe të tretë, në institucionet e arsimit të lartë" të ndryshuar;
- Dëshmi ose vërtetime në lidhje me kualifikime, trajnime, provime pasuniversitare, ose artikuj shkencorë që mund të kenë kryer apo pjesëmarrje në konferenca shkencore, eksperiencia akademike;
- Deklaratë personale e studentit për përballimin e shpenzimeve të programit të studimeve nëse do të vetëfinancohet;
- Projekt propozimin e kërkimit shkencor, ku të evidentohen objektivat e kërkimit shkencor, metodologjia që do të ndiqet, nevoja për studim të thelluar në fushën e propozuar dhe risitë që pritet të sjellë punimi;
- Vërtetim nga qendra e punës nëse kandidati është i punësuar;
- Mandat pagesë për tarifën e aplikimit;
- Vetëdeklarim të aplikantit se do të zbatojë standardet shkencore dhe etike ndaj tij;
- Vetëdeklarimi që nuk është subjekt i asnjë mase disiplinore të marrë ndaj tij;





REPUBLIKA E SHQIPËRISE

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
FAKULTETI I SHKENCAVE TË EDUKIMIT

12.2 Kosto të përgjithshme e studimeve dhe tarifa e shkollimit në Doktoraturë

Fakulteti i Shkencave të Edukimit ka staf akademik në raport mbi 95% me tituj dhe grada: Prof.dr (3), Prof.as.dr. (14), prof.as. (1), Dr. (15), Doc. 2, Doc/Dr. (3) dhe vetëm 5 % janë MSc (2). Bazuar në koeficientët e rekomanduar nga MAS për mënyrën e llogaritjes së koston, pagën mesatare të punonjësve akademikë me titullin Profesor, pagën mesatare të punonjësve ndihmës mësimorë, 11% e shpenzimeve operative dhe 23% e investimeve në buxhetin e parashikuar të vitit 2021, është llogaritur kosto e përgjithshme e studimeve për një doktorant në FSHE dhe parashikohet në vlerën 1.343.473 lekë.

Nr.	Shpenzime	Lek
1	Shpenzime për pagat dhe sigurimet shoqërore	1.065.708
-	Paga Prof dhe Prof.As.	816.954
-	Paga personel / ndihmës	96.249
-	Sigurime shoqërore	152.505
2	Shpenzime të tjera	277,764
-	Për shërbime	89,865
-	Për investime	187,899
	Shuma e shpenzimeve	1,343,473

Këto të dhëna i janë referuar pagës mesatare të punonjësve akademikë në fakultet, shpenzimeve të planifikuara në buxhetin e vitit 2021 dhe koeficientëve në bazë të studimeve të kryera nga MAS për numrin mesatar të studentëve doktorantë për një grup mësimor, i cili është 5 studentë, ndërkohë që numri i i punonjësve mësimorë për një student doktorant është 2.5 punonjës. Universitetet publike financohen kryesisht me bashkëfinancim, Grant nga Buxheti i Shetit dhe të ardhurat e Universitetit, ndërkohë që sipas koston së





REPUBLIKA E SHQIPËRISE

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
FAKULTETI I SHKENCAVE TË EDUKIMIT

përgjithshme të studimeve për programin e studimit "Doktoraturë në shkencë edukimi", tarifa e shkollimit është parashikuar që të përballohet 80% nga të ardhurat e krijuara nga pagesa e tarifës vjetore të studentëve doktorantë dhe 20% nga granti i Buxhetit të Shtetit duke llogaritur kuotën prej 7 studentë.

Kohëzgjatja normale e studimit të jetë 3-5 vite akademike. Tarifa e shkollimit për të gjithë kohëzgjatjen e programit të studimit "Doktoraturë në shkencë edukimi" të jetë 450.000 lekë. Tarifa e shkollimit për Ciklin e tretë të studimeve paguhet me kështu të barabarta në tri vitet e para të studimeve.

KOORDINATORI

Prof.as.dr. Elisabeta OSMANAJ

